FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 4	2000	Mars

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8566 datë 20.1.2000	Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 16.12.1999.....	71
Ligj nr.8567 datë 20.1.2000	Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 31.12.1999.....	71
Ligj nr.8568 datë 20.1.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.8408, datë 25.9.1998, "Për Policinë e Ndërtimit".....	72
Ligj nr.8569 datë 20.1.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën Ndërkombëtare për Standartet e Kualifikimit, Atestimit dhe të Shërbimit për Detarët", të vitit 1995....	73
Ligj nr.8573 datë 3.2.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes "Umbrella" për kuadrin institucional të krijimit të sistemeve ndërshtetërore të transportimit të naftës dhe të gazit".....	74
Ligj nr.8574	Për ratifikimin e "Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së	83

datë 3.2.2000	Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Zvicrës për Statusin e Personelit Zvicerian që do të angazhohet në shkatërrimin e mbetjeve toksike të magazinuara në depot e ushtrisë shqiptare".....	
Ligj nr.8575 datë 3.2.2000	Për një ndryshim në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, me ligjin nr.8286, datë 16.2.1998 dhe me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998.....	91
Ligj nr.8576 datë 3.2.2000	Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë....	92
Ligj nr.8577 datë 10.2.2000	Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.....	101
Ligj nr.8578 datë 10.2.2000	Për Teatrin.....	123

L I G J
Nr.8566, datë 20.1.2000

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.4, DATË 16.12.1999

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit i Këshillit të Ministrave nr.4, datë 16.12.1999 "Për një ndryshim në ligjin nr.8162, datë 7.11.1996 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1630, datë 1.11.1996", botuar në Fletoren Zyrtare nr.35, dhjetor 1999.

Shpallur me dekretin nr.2538, datë 4.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J

Nr. 8567, datë 20.1.2000

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.5, DATË 31.12.1999

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit i Këshillit të Ministrave nr.5, datë 31.12.1999 "Për përdorimin e fondeve buxhetore për mbështetjen financiare të industrisë së kromit dhe bakrit", botuar në Fletoren Zyrtare nr.36, dhjetor 1999.

Shpallur me dekretin nr.2539, datë 4.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8568, datë 20.1.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8408, DATË 25.9.1998 "PËR POLICINË E NDËRTIMIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pika 2 ndryshohet si vijon:
2. Të vendoset gjoba për shkelje të dispozitave ligjore të mësipërme. 60 për qind e të ardhurave të tyre të kalojnë në buxhetin e shtetit dhe 40 për qind në favor të Policisë së Ndërtimit.

Neni 2

Në fund të nenit 11 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Financave për të nxjerrë udhëzime të përbashkëta për mënyrën e administrimit të të ardhurave nga gjobat e vjelura nga Policia e Ndërtimit."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2540, datë 4.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8569, datë 20.1.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR STANDARDET E KUALIFIKIMIT, ATESTIMIT DHE TË SHËRBIMIT PËR DETARËT", TË VITIT 1995

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Atestimit dhe të Shërbimit për Detarët", të vitit 1995.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2541, datë 4.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8573, datë 3.2.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES "UMBRELLA" PËR KUADRIN INSTITUCIONAL TË KRIJIMIT TË SISTEMEVE NDËRSHTETËRORE TË TRANSPORTIMIT TË NAFTËS DHE TË GAZIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja "Umbrella" për kuadrin institucional të krijimit të sistemeve ndërshtetërore të transportimit të naftës dhe të gazit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2553, datë 14.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJA
"UMBRELLA" PËR KUADRIN INSTITUCIONAL PËR KRIJIMIN E SISTEMEVE NDËRSHTETËRORE TË TRANSPORTIMIT TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Shtetet palë të kësaj Marrëveshjeje (që më poshtë do të përmenden si palë),

duke pasur të qartë se rrugët e qëndrueshme për kalimin e naftës dhe gazit drejt tregjeve botërore do të jenë të rëndësishme në prosperitetin e ardhshëm dhe sigurimin e energjisë së palëve;

të vetëdijshëm se të dhënat për marrjen e vendimeve për tranzitimin e naftës dhe të gazit natyror dhe/ose nënprodukteve të tyre do të nxirren nga të gjithë faktorët ligjorë, teknikë, tregtarë, mjedisorë dhe financiarë, në bashkëpunim me shtete të tjera të interesuara, si dhe me kompani vendase dhe të huaja që investojnë në shfrytëzimin e burimeve të hidrokarbureve;

duke respektuar rregullat e ekonomisë së tregut në fushën e naftës dhe të gazit, si rregullat dhe direktivat e aplikueshme në vendet e BE-së dhe duke dashur të kontribuojnë në zhvillimin e praktikave dhe rregullave ndërkombëtarë që drejtojnë veprimtaritë e tranzitimit në fushën e naftës dhe të gazit;

të ndërgjegjshëm se shtetet kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në reduktimin e rreziqeve të investimit dhe të tranzitimit;

duke gjykuar që mbrojtja, nxitja dhe trajtimi i investimeve të huaja dhe i investitorëve të huaj, sipas standarteve të pranuara botërisht dhe në përputhje me rregullat e ligjeve ekonomike ndërkombëtare përbëjnë masat për të zhvilluar sektorin e tranzitimit të naftës dhe të gazit;

të vendosur për të vendosur rregulla dhe mekanizma të përgjithshëm që sigurojnë operacion efektiv të Sistemeve Ndërshtetërore të Transportimit të Naftës dhe të Gazit, në përputhje me rregullat dhe praktikat në fuqi në industrinë botërore të naftës dhe të gazit;

duke pasur parasysh parimet e deklaruara në Traktatin e Kartës së Energjisë ranë dakord si më poshtë:

PËRKUFIZIME DHE TITUJ

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

I. Konstruksion do të thotë ndërtimi i sistemeve të reja të transportimit të naftës dhe të gazit apo të ndonjë pjese të një Sistemi Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi.

II. Komiteti i Emergjencës i përshkruar në nenin 8 paragrafi 4 të kësaj Marrëveshjeje është komiteti i përbërë nga përfaqësues të autorizuar të të gjitha palëve pjesëmarrëse, që kanë fuqi ligjore për të bërë rekomandime për bashkërendimin e të gjithë hapave; masave dhe veprimeve të përbashkëta që duhet të merren nga qeveritë e çdo pale pjesëmarrëse në territorin e vet, të nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e pajisjeve të një Sistemi Ndërshtetëror Transporti të Naftës dhe Gazit, të përcaktuar në vijim të kësaj Marrëveshjeje, ndaj ngjarjeve si fatkeqësitë natyrore, tërmetet, ndotjet radioaktive dhe kimike, revoltat civile, aktet e terrorizmit apo sabotimet, dëmet kriminale dhe ngjarje të tjera me natyrë të ngjashme.

III. Forma e Integruar e Implementimit të Projektit është forma e bashkëpunimit e zgjedhur nga palët pjesëmarrëse për krijimin e një Sistemi Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi, i cili nënkupton një njësi të vetme legale ose një grup njësish legale, me dy ose më shumë funksione të ndara, siç është përshkruar në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë formë tjetër integrimi.

IV. Komiteti Ndërshtetëror i përshkruar në neni 8 paragrafi 3 të kësaj Marrëveshjeje është komiteti i përbërë nga përfaqësues të autorizuar të të gjitha palëve pjesëmarrëse që kanë fuqi ligjore të monitorojnë, në emër dhe në interes të palëve të tilla, implementimin e vendimeve të tyre, për të krijuar një ose më tepër Sisteme Ndërshtetërore të Transportimit të Naftës dhe Gazit

V. Sistem Ndërshtetëror i Transportimit të Naftës dhe Gazit nënkupton një sistem transporti të naftës dhe gazit natyror dhe/ose të nënprodukteve të tyre, që kalojnë në territoret e më shumë se një shteti.

VI. Mirëmbajtje do të thotë veprimtari teknike e nevojshme për të ruajtur një Sistem Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi ose një pjesë apo pajisje të një sistemi të tillë transporti në një gjendje të mirë funksionimi, për atë qëllim për të cilin sistemi është projektuar në përputhje me sigurinë e aplikueshme teknike dhe standardet e mjedisit.

VII. Njësia e Mirëmbajtjes është një njësi legale ose një grup njësish legale të krijuara ose të seleksionuara në vijim të kësaj Marrëveshjeje, për të marrë përsipër funksionin e Mirëmbajtjes së një Sistemi Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi ose të një pjese të tij.

VIII. Operacion do të thotë të gjitha veprimtaritë të cilat janë të nevojshme për një funksionim të vazhdueshëm, pa ndërprerje, korrekt dhe efikas të Sistemit Ndërshtetëror të Transportit të Naftës dhe Gazit, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e aplikuara.

IX. Njësi e Operacionit është një njësi legale ose një grup njësish legale të krijuara ose të seleksionuara në vijim të kësaj Marrëveshjeje, për të ndërmarrë një Operacion të një Sistemi Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi.

X. Njësi të Tjera Legale të Interesuara, të referuara në nenet 3 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje, do të thotë Njësi Kompetente të Autorizuara të përshkruara në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje.

XI. Palë Pjesëmarrëse do të thotë palët nëpër territorin e të cilëve një Sistem Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi është vendosur në vijim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

XII. Praktika apo zakone, të referuara në Preambulën dhe në nenin 3, janë forma dhe mënyra të drejtimit të veprimtarive specifike teknike, tregtare dhe financiare brenda një industrie apo tregu specifik, të krijuara nëpërmjet praktikave të zakonshme dhe të ndjekura nga operacione profesionale brenda të njëjtës industri apo treg.

XIII. Projekt do të thotë plani dhe ndërmarrja për të realizuar një veprimtari ose disa veprimtari specifike në kuadrin e një Sistemi Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi të krijuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

XIV. Projekt Management është mobilizimi i një ekipi multiprofesional që kërkon të realizojë gjithë Projektin e Rehabilitimit dhe të Konstruksionit të një Sistemi Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi, duke mbikqyrur dhe bashkërenduar veprimtaritë që kanë lidhje me prodhimin, prokurimin, monitorimin teknik dhe supervizionin, menaxhimin e konstruksionit dhe angazhimin për një Projekt të tillë, me objektiva të aplikueshëm në afatin kohor, cilësi dhe kosto.

XV. Njësia e Menaxhimit të Projektit është një njësi legale ose një grup njësish legale të krijuara apo të seleksionuara në vijim të kësaj Marrëveshjeje për të ndërmarrë funksionin e Menaxhimit të Projektit.

XVI. Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Njësia e Operacionit mund të jenë dy njësi të ndryshme, që veprojnë në dy faza të ndryshme të implementimit të Projektit dhe Operacionit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, vetëm në qoftë se funksioni i dyfishtë i menaxhimit të projektit (përpara datës së përfundimit) dhe Operacioni i Projektit (pas datës së përfundimit) i është besuar një njësie të vetme legale ose një grupi njësish legale sipas termave të nenit 6 paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje.

XVII. Protokoll ose Protokolle do të thotë çdo marrëveshje e mëvonshme e përfunduar nga dy ose më tepër palë në kuadrin e implementimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me parimet bazë, rregullat dhe procedurat e vendosura në këtë Marrëveshje, që do të jenë anekse të saj.

XVIII. Rehabilitim do të thotë rigjallërimi, rindërtimi ose rinovimi i çdo sistemi Ndërshtetëror Transporti Nafte dhe Gazi apo i një pjese ekzistuese të një sistemi të tillë transportimi.

XIX. Umbrella Agrement do të thotë kjo Marrëveshje e cila përcakton kuadrin e nevojshëm në termat e parimeve bazë, të rregullave dhe procedurave për implementimin e fushës së aplikimit, si dhe për mbrojtjen e çdo pale të tretë që vepron në kuadrin institucional të përcaktuar nga ajo.

2. Titujt në këtë Marrëveshje janë të destinuara vetëm për lehtësi në referim dhe nuk do të përdoren për interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1
Angazhim i përgjithshëm

Palët do të bashkëveprojnë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, për të krijuar, sipas termave dhe kushteve të pranuara në mënyrë të ndërsjellë, një ose më tepër SNTNG, me anë të rehabilitimit të sistemeve ekzistuese të transportimit të naftës dhe gazit, Konstruksionit, ku është e përshtatshme, të SNTNG të ri(rinj) dhe të Operacionit dhe Mirëmbajtjes së këtyre sistemeve transportuese.

Neni 2
Fusha e aplikimit

1. Për qëllimet e nenit 1, palët bien dakord të angazhohen apo të vazhdojnë negociata bilaterale dhe/ose multilaterale me palë të tjera, për të vendosur me anë Protokolli të veçantë se ato dëshirojnë që pjesët ekzistuese apo nën Konstruksion, të SNTNG që kalon në territorin e tyre të përdoren si pjesë e një apo më tepër SNTNG, që do të krijohet, mirëmbahet dhe operohet në vijim të kësaj Marrëveshjeje, si dhe ato pranojnë që pjesët e reja që do të ndërtohen, operohen dhe mirëmbahen në territorin e tyre do të jenë pjesë e SNTNG të sipërpërmendur.

2. Pa dashur të kufizojë krijimin e interkoneksioneve midis dy ose më tepër SNTNG, të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje, sisteme të tilla transportimi mund të konsiderohen si projekte të veçanta, për t'u projektuar, konstruktuar, operuar dhe mirëmbajtur në përputhje me konsideratat e ndryshme teknike, tregtare, financiare dhe mjedisore. Çdo palë mund të bjerë dakord me palët e tjera për të krijuar më tepër se një SNTNG.

Neni 3
Operacioni

1. Pa dashur të kufizojë nenin 7 paragrafin 2 dhe duke pasur parasysh nevojën për të pasur rregulla që sigurojnë një funksionim efikas të një SNTNG, të krijuar sipas kësaj Marrëveshjeje, operacioni i një sistemi të tillë, në qoftë se bihet dakord nga palët pjesëmarrëse, mund t'i caktohet një njësie operacioni të përbashkët, që do të krijohet ose selektohet sipas parimeve, rregullave dhe procedurave, për të cilat do të negociohet dhe do të bihet dakord nga palët pjesëmarrëse dhe përkatësisht nga Njësi të tjera Legale të Interesuara.

2. Njësia e operacionit mund të hyjë në një marrëveshje operacioni të përbashkët me palët pjesëmarrëse dhe, përkatësisht, me Njësi të tjera Legale të Interesuara, duke përshkruar parimet dhe rregullat sipas të cilave SNTNG i krijuar nga këto palë do të operohet.

3. Pa dashur të kufizojë nenin 7, dhe kur nuk është shprehur ndryshe në një protokoll që do të jetë më vonë aneks, një njësi operacioni e përbashkët mund t'i sigurojë shërbime transporti blerësve dhe furnizuesve të naftës dhe gazit, në përputhje me marrëveshjet e transportimit të naftës dhe gazit, që ndjekin standartet dhe zakonet ndërkombëtare të industrisë së naftës dhe gazit.

Neni 4
Rehabilitimi dhe konstruksioni

1. Përveçse kur nuk është shprehur ndryshe në këtë marrëveshje, çdo palë pjesëmarrëse, në zbatim të vendimit të dy ose më tepër palëve pjesëmarrëse në lidhje me krijimin e një ose më tepër SNTNG, ruan të drejtën dhe përgjegjësinë për të rehabilituar SNTNG ekzistues që kalon nëpër territorin e vet dhe të ndërtojë një SNTNG të ri që kalon në territorin e vet në përputhje me rregullat kombëtare dhe rregulloret në fuqi të vendit të përmendur.

2. Dispozita e paragrafit 1 nuk përjashton të drejtën e një pale për të hyrë në marrëveshje me palë të tjera pjesëmarrëse, në lidhje me rehabilitimin dhe ndërtimin e pjesëve të një SNTNG që kalon në territorin e tyre. Për këtë efekt, dy ose më shumë palë mund të vendosin t'ia caktojnë projektin rehabilitimin dhe konstruksionin e punës që shtrihet në territoret e tyre, një njësie legale ose një grupi njësish legale të caktuara ose të seleksionuara sikurse palët pjesëmarrëse mund të vendosin bashkërisht.

3. Për të siguruar homogjenitet teknik dhe efikasitet operacional të një ose më tepër SNTNG që do të krijohet midis një ose më tepër palëve pjesëmarrëse, sikurse palët pjesëmarrëse bien dakord të aplikojnë, kur duke kundërshtuar, përsa i përket paragrafëve 1 dhe 2, të rehabilitimit dhe konstruksionit të pjesëve kombëtare të një ose më tepër SNTNG, bien dakord bashkërisht për specifikimet teknike, të cilat janë të njohura botërisht nga industria e naftës dhe gazit.

Neni 5
Mirëmbajtja

1. Dispozitat e nenit 4 ngjashmërisht aplikohen për mirëmbajtjen e pjesëve të rehabilituara ose të ndërtuara rishtas të një ose më tepër SNTNG, të krijuara në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Subjekt i dispozitave të nenit 3 paragrafi 1, kur një njësi operacioni e përbashkët operon një SNTNG të krijuar në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe në qoftë se mirëmbajtja e një sistemi të tillë i caktohet një njësie legale ose një grup njësish legale, të ndryshme nga njësia e operacionit të përbashkët, siç përshkruhet në nenin 3, njësia legale ose grupi i njësive legale, përgjegjës për mirëmbajtjen e një sistemi të tillë transportimi, do të operojë nën kontrollin dhe supervizionin e njësisë së operacionit, sikundër edhe marrëveshja e mirëmbajtjes, që do të bëhet në bazë të këtij neni dhe Marrëveshja e Përbashkët e Operacionit, të deklaruara në nenin 3 paragrafi 2, do të deklarojnë shprehimisht.

Neni 6
Menaxhimi i projektit

1. Në zbatim të vendimit të tyre për të krijuar një SNTNG në përputhje me këtë Marrëveshje, palët pjesëmarrëse dhe, përkatësisht, Njësitë e tjera Legale të Interesuara, në qoftë se do të bien dakord kështu, mund të vendosin t'ia caktojnë përgjegjësinë e plotë të studimit të fisibilitetit, projektit dhe supervizionit të rehabilitimit dhe konstruksionit të një sistemi të tillë transportimi një njësie të menaxhimit të projektit të përbashkët që do të krijohet ose seleksionohet nga palët pjesëmarrëse dhe, përkatësisht, nga Njësitë e tjera Legale të Interesuara, sipas parimeve, rregullave dhe procedurave, të pranuara reciprokisht, për të cilat do të negociohet dhe do të bihet dakord nga palët pjesëmarrëse dhe, përkatësisht, nga Njësitë e tjera Legale të Interesuara.

2. Pa dashur të kufizojë dispozitat e nenit 7 paragrafi 2, asgjë nuk i përjashton palët pjesëmarrëse dhe, përkatësisht Njësitë e tjera Legale të Interesuara, nga të caktuarit e funksionit të Njësisë së Menaxhimit të Projektit një njësie operacioni të përbashkët të përshkruar në nenin 3 paragrafi 1.

Neni 7
Format e integruara të implementimit të projektit

1. Duke pasur parasysh kërkesat specifike teknike, tregtare dhe financiare për krijimin e një SNTNG individual, në përputhje me këtë Marrëveshje, palët pjesëmarrëse mund të bien dakord t'u japin dy ose më tepër funksione, ndërmjet atyre të shqyrtuara në mënyrë të ndarë nga neni 3 te neni 6, një njësie të vetme legale ose një grupi njësish legale, që do të krijohet ose seleksionohet nga palët pjesëmarrëse, siç është përshkruar në mënyrë më specifike në:

a) neni 4 paragrafi 2, në kombinim me nenin 5 paragrafi 1, për funksionet e rehabilitimit/konstruksionit dhe mirëmbajtjes;

b) neni 3 paragrafi 1, në kombinim me nenin 5 paragrafi 2, për funksionet e mirëmbajtjes dhe operacionit.

c) neni 6 paragrafi 2, për funksionet e menaxhimit dhe operacionit të projektit;

d) neni 6 paragrafi 2, në kombinim me nenin 5 paragrafi 2, për funksionet e menaxhimit të projektit, operacionit dhe mirëmbajtjes.

2. Palët mund të adoptojnë ndonjë formë tjetër të integruar të implementimit të projektit, që përfshin, por që nuk kufizon operacionin e përbashkët, për të zbatuar vendimet e tyre për të krijuar një ose më tepër SNTNG, në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 8
Çështje që kanë të bëjnë me juridiksionin ekskluziv të palëve

1. Në zbatim të vendimit për të krijuar një ose më tepër SNTNG në përputhje me këtë Marrëveshje, palët pjesëmarrës do të vendosin, me anë të protokolleve të veçantë, rregullat që do të kontrollojnë çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin nga secila palë pjesëmarrëse të juridiksionit të vet ekskluziv në territorin e vet, si dhe mbi personat fizikë dhe juridikë që veprojnë në këtë territor, që kanë të bëjnë me çështje që përfshijnë, por që nuk kufizojnë sigurimin social, legjislacionin e punës, rregulloret e konstruksionit, procedurat e licensimit, rregulloret e sigurimit dhe të ruajtjes së shëndetit, çështjet fiskale dhe doganore dhe legjislacionin e mbrojtjes së mjedisit, në lidhje me projektimin, rehabilitimin konstruksionin, mirëmbajtjen dhe operacionin e pjesëve kombëtare të një SNTNG, të krijuar në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Përveçse nuk është shprehur ndryshe në këtë Marrëveshje ose në protokollet që më vonë do të jenë aneks i saj, asnjë palë nuk mund të modifikojë legjislacionin e saj kombëtar në atë shkallë që një legjislacion i tillë do të prekte (dëmtonte) kushtet e projektimit, rehabilitimit, konstruksionit, mirëmbajtjes dhe operacionit të një SNTNG, të krijuar në përputhje me këtë Marrëveshje ose protokollet që më vonë do të jenë aneksi i saj, pasi kjo Marrëveshje dhe protokollet e mëvonshme, aneks i kësaj marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi.

3. Palët do të bashkëpunojnë për të krijuar, me anë të një protokolli të mëvonshëm, aneks i

kësaj Marrëveshjeje, një Komitet Ndërshtetëror të autorizuar, i cili do të ketë fuqi ligjore të monitorojë, në emër dhe në interes të palëve pjesëmarrëse, implementimin e vendimeve të tyre për të krijuar një ose më tepër SNTNG, të krijuar në përputhje me këtë Marrëveshje.

4. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë që të krijojnë, nëpërmjet një protokolli që do t'i bashkëngjitet dokumentit, një Komitet Emergjence të autorizuar, i cili do të japë rekomandime në lidhje me koordinimin e të gjithë hapave, masave dhe veprimeve të përbashkëta që duhen realizuar nga qeveria e secilës palë pjesëmarrëse brenda territorit të saj, që janë të nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e faciliteteve të një Sistemi Ndërshtetëror për Transportimin e Naftës dhe Gazit, të krijuar në përputhje me këtë Marrëveshje, ndaj aksidenteve të tilla si fatkeqësitë natyrore, tërmetet, ndotjet radioaktive ose kimike, trazirat civile, aktet e terrorizmit ose sabotazhi, veprimtaritë kriminale dhe rasteve të tjera të kësaj natyre. Këto evenimente, si dhe funksionet dhe autoriteti i Komitetit të Emergjencës do të përcaktohen nga palët pjesëmarrëse në bazë të marrëveshjes reciproke për secilin Sistem Individual të Transportimit të Naftës dhe Gazit, të krijuar në përputhje me Marrëveshjen aktuale.

5. Protokollet që do t'i bashkëngjiten Marrëveshjes aktuale do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe do të jenë të vlefshme vetëm për palët që kanë nënshkruar këto protokolle.

Neni 9
Mbrojtja e mjedisit

Në zbatim të Marrëveshjes aktuale, palët bien dakord të zhvillojnë bashkëpunim më të ngushtë ndërqeveritar me synim krijimin e institucioneve të përbashkëta që do të veprojnë në përputhje me rregullat ndërkombëtare, si ato të deklaruara në Protokollin Kyoto, bashkëngjitur Traktatit Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës dhe Protokollit të Kartës së Energjisë për Efiçencën e Energjisë dhe Aspektet e Lidhura të Mjedisit, duke marrë në konsideratë kushtet vendore të mjedisit dhe të zbatojë politika të përbashkëta që mbrojnë mjedisin nga efektet e dëmshme të shkaktuara nga projektimi, ndërtimi, rehabilitimi, mirëmbajtja dhe operimi i një ose më shumë Sistemeve Ndërshtetërore të Transportimit të Naftës dhe Gazit, të krijuara në përputhje me Marrëveshjen aktuale.

Neni 10
Zbatimi në urdhëresat ligjore kombëtare

1. Palët do të marrin të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të inkorporojnë dhe zbatojnë kushtet e Marrëveshjes aktuale në urdhëresat e tyre ligjore kombëtare

2. Në rastet kur Marrëveshja kërkon ose sugjeron konkludimin e një protokolli të veçantë që do t'i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje, ky protokoll ose këto protokolle do të negociohen dhe miratohen nga palët pjesëmarrëse, duke marrë në konsideratë kërkesat specifike për zbatimin e çdo projekti të veçantë që duhet zbatuar në kuadrin e Marrëveshjes aktuale. Inkorporimi dhe zbatimi i këtij protokolli ose këtyre protokolleve në urdhëresat ligjore kombëtare të palëve pjesëmarrëse do të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe legjislative të palëve të mësipërme.

3. Një palë nuk mund të shfrytëzojë dispozitat e urdhëresave të saj ligjore kombëtare si justifikim për moszbatim të detyrimeve të saj nën Marrëveshjen aktuale dhe protokolleve bashkëngjitur.

Neni 11
Garancia shtetërore dhe ndërshtetërore e performancës

Secila palë garanton ekzekutimin e saktë dhe në kohë të detyrimeve të saj që dalin nga Marrëveshja aktuale dhe protokollet, aneks të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me të gjitha palët e tjera, si dhe në lidhje me çdo palë të tretë që futet në kontratë ose marrëveshje me këtë palë për projektin, rehabilitimin, konstruksionin, financimin, operacionin dhe mirëmbajtjen e një sistemi ndërshtetëror të Transportimit të Naftës dhe Gazit, të krijuar në përputhje me Marrëveshjen aktuale.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e marrëveshjes aktuale dhe protokolleve bashkëngjitur, si dhe çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet palëve dhe një pale të tretë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e çdo kontrate ose marrëveshjeje që është bërë ndërmjet një pale dhe kësaj pale të tretë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe Protokolleve bashkëngjitur, do të zgjidhen në përputhje me rregullat që do të përcaktohen në një protokoll të veçantë të krijuar nga palët.

Neni 13
Njësitë kompetente të autorizuara

1. Secila palë do të caktojë dhe do të njoftojë palët e tjera për autoritetin, agjencinë, ndërmarrjen shtetërore ose çdo njësi tjetër ligjore të autorizuar kombëtare, e cila do të jetë përgjegjëse, sipas legjislacionit të saj kombëtar, për zbatimin e Marrëveshjes aktuale në secilin sektor (naftë dhe gaz) që mbulohet nga kjo Marrëveshje.

2. Palët pranojnë dhe garantojnë detyrimet e ndërmarra nga këto njësi për zbatimin e Marrëveshjes aktuale dhe protokolleve bashkëngjitur, si detyrime të tyre.

Neni 14
Lidhje me traktatet e tjera ndërkombëtare

1. Dispozitat e Marrëveshjes aktuale nuk përjashtojnë të drejtën e palëve të kenë akses në forma të tjera të bashkëpunimit ndërqeveritar për sektorin e tranzitimit të naftës dhe gazit.

2. Dispozitat e Marrëveshjes aktuale nuk mund të interpretohen sikur modifikojnë ose u japin fund traktateve të tjera ndërkombëtare në fuqi për sektorin e tranzitimit të naftës dhe gazit, si dhe çdo traktat ndërkombëtar të realizuar nga palët me shtetet e tjera, që ka për synim mbrojtjen, trajtimin dhe promovimin, brenda territorit të palëve, tek investimet e huaja me origjinë nga këto shtete të tjera.

Neni 15
Dispozitat përfundimtare

1. Marrëveshja aktuale është me kohëzgjatje të papërcaktuar.

2. Marrëveshja aktuale do të ratifikohet nga parlamentet ose çdo njësi tjetër kompetente e shteteve nënshkruese. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen te Depozituesi. Depozituesi i Marrëveshjes aktuale do të jetë Ukraina.

3. Marrëveshja aktuale do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit nga një shtet që është nënshkrues i kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja aktuale do të jetë e hapur për aksesim nga data në të cilën Marrëveshja mbyllet për nënshkrim. Instrumentet e aksesimit do të depozitohen te Depozituesi. Për secilën palë që do të depozitojë insturmentin e saj të aksesimit ose ratifikimit, pasi Marrëveshja aktuale të ketë hyrë në fuqi, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit te Depozituesi.

4. Marrëveshja aktuale është subjekt i parimeve të përgjithshme të ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë Konventën e Vienës për ligjin e traktateve.

Neni 16
Tekstet autentike

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, që janë të autorizuar, kanë nënshkruar Marrëveshjen aktuale në anglisht dhe gjuhën zyrtare të secilës palë. Në rast keqkuptimesh do të ketë përparësi teksti në anglisht.

Marrëveshja aktuale depozitohet te Depozituesi, i cili do ta ruajë në arshivat e tij. Secila palë do të marrë nga depozituesi një kopje autentike të Marrëveshjes aktuale. Depozituesit të kësaj

Marrëveshjeje i kërkohet të transmetojë për regjistrim një kopje autentike të Marrëveshjes aktuale në Sekretariatin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, sipas artikullit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Republika e Armenisë
Republika e Shqipërisë
Republika e Azerbajxhanit
Republika e Bjellorusisë
Gjeorgjia
Republika e Kazakistanit
Republika e Kyrgyzit
Republika e Moldavisë
Rumania
Republika e Taxhikistanit
Republika e Turkmenistanit
Ukraina
Republika e Uzbekistanit
Republika e Bullgarisë
Republika e Kroacisë

L I G J
Nr.8574, datë 3.2.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL TË ZVICRËS PËR STATUSIN E PERSONELIT ZVICERIAN QË DO TË ANGAZHOHET NË SHKATËRRIMIN E MBETJEVE TOKSIKE TË MAGAZINUARA NË DEPOT E USHTRISË SHQIPTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Zvicrës për statusin e personelit zvicerian që do të angazhohet në shkatërrimin e mbetjeve toksike, të magazinuara në depot e ushtrisë shqiptare".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHPALLUR ME DEKRETIN NR.2554, DATË 14.2.2000 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REXHEP MEIDANI

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN, PËR STATUSIN E PERSONELIT ZVICERAN QË DO TË ANGAZHOHET NË SHKATËRRIMIN E MBETJEVE TOKSIKE TË MAGAZINUARA NË OBJEKTET E REGJIMENTIT TË MBROJTJES NGA ARMËT E DËMTIMIT NË MASË (ADM), I VENDOSUR NË TIRANË NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I. PËRKUFIZIMET

1. Termat e veçanta të përdorura në këtë Marrëveshje janë të njëjta me ato që përdoren në Politikën e Këshillit të Partneritetit Euro-Atllantik (EAPC) për "Bashkëpunimin e përmirësuar në fushën e lehtësimit të pasojave të katastrofave ndërkombëtare".

II. ZBATIMI I MARRËVESHJES

2. Kërkesat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë nëse nuk ekziston ndonjë kusht specifik që e përjashton këtë.

III. IMUNITETET E PËRGJITHSHME

3. Republika e Shqipërisë garanton personelin zviceran për shkatërrimin e mbetjeve tokstike të magazinuara në objektet e Rregjimentit të Mbrojtjes nga ADM, i vendosur në Tiranë në territorin e Republikës së Shqipërisë, proces i cili do të kryhet nga Zvicra (prej këtej e tutje : Personeli Zviceran) duke përfshirë pronën, fondet, asetet dhe personelin e saj, privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë Marrëveshje.

IV. STATUSI I OPERACIONIT

4. Personeli Zviceran do të shmangë çdo veprim ose veprimtari që bie ndesh me natyrën e detyrave të tij ose që nuk i përgjigjet frymës së kësaj Marrëveshjeje dhe rregullimeve shtesë që rrjedhin prej saj. Personeli Zviceran do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret vendase. Kryetari i Personelit Zviceran do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar vëzhgimin ndaj këtyre detyrimeve.

Identifikimi dhe shenjat e automjeteve

5. Qeveria e Republikës së Shqipërisë i garanton personelit Zviceran të drejtën për të shfaqur brenda territorit të saj flamurin kombëtar zviceran ose të tjera shenja të përshtatshme identifikimi me shtabin, kampingun ose objekte të tjera dhe në automjetet, motorrat, avionet dhe mjetet e tij lundruese. Personeli i angazhuar në kuadrin e operacionit do të ketë në uniformë shenjat e tij përkatëse.

Komunikimi

6. Siç parashikohet nga "Konventa mbi komunikimin në raste katastrofash", Qeveria e Republikës së Shqipërisë i garanton Personelit Zviceran të drejtën për të përdorur mjete për komunikim që do të nevojiten gjatë kryerjes së detyrës së tij.

7. Personelit Zviceran i jepet e drejta për të instaluar dhe operuar radiostacione dhënëse e marrëse, si dhe sisteme satelitore për të bërë të mundur lidhjen e pikave të ndryshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me njëra-tjetrën, si dhe me rrjetin e tyre kombëtar të telekomunikacionit. Shërbimet e telekomunikacionit do të operojnë në përputhje me Konventën dhe Rregullat e Telekomunikacionit Ndërkombëtar dhe frekuencat, në të cilat do të operojnë këto stacione, do të përcaktohen në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

8. Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, Presonelit Zviceran i jepet e drejta për një komunikim të pakufizuar me radio (duke përfshirë satelitët, radiot e dorës dhe celularët), telefonë, telegrafë, faksimile dhe çdo mënyrë tjetër; ndërtimin e fasiliteteve të nevojshme për të mirëmbajtur këto komunikime brenda dhe ndërmjet objekteve të Personelit Zviceran, ku përfshihen shtrirja e kabllove dhe e linjave tokësore, si dhe ndërtimin e radiostacioneve të palëvizshme e të lëvizshme, marrës, dhënës e repetitorë. Frekuencat në të cilat do të operojnë radiostacionet do të përcaktohen në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

9. Personelit Zviceran i lejohet që me anë të mjeteve të tij të zbatojë procedurat e veta në lidhje me marrjen në dorëzim dhe transportin e postës private të adresuar ose të nisur nga pjesëtarët e Personelit Zviceran. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të informohet mbi natyrën e këtyre procedurave dhe merr përsipër të mos ndërhyjë ose të mos ushtrojë censurë mbi postën e Personelit Zviceran ose të pjesëtarëve të tij. Në rast se procedurat postare që zbatohen ndaj postës private të pjesëtarëve të Personelit Zviceran kanë lidhje me shkëmbim monedhash ose me transport të kolive postare, për kushtet nën të cilat do të zhvillohen këto operacione, do të bihet dakord me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Udhëtim dhe transport

10.Qeveria e Republikës së Shqipërisë i garanton Personelit Zviceran dhe pjesëtarëve të tij së bashku me automjetet, mjetet lundruese, avionët dhe pajisjet e tyre lirinë e lëvizjes brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, e nevojshme për përmbushjen e detyrës së tyre. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër t'i japë Personelit Zviceran informacion që mund të jetë i vlefshëm për të lehtësuar lëvizjen e tyre.

11. Automjetet e Personelit Zviceran, duke përfshirë të gjitha llojet e automjeteve, mjeteve lundruese dhe avionët nuk do të jenë subjekt i regjistrimit ose licensimit nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, duke theksuar se të tilla automjete do të kenë siguracion të palëve të treta, e cila kërkohet nga legjislacionet përkatëse.

12. Personeli Zviceran mund të përdorë rrugët, urat, tunelet, kanalet dhe të tjera rrugë ujore, infrastrukturat e porteve dhe pistave ajrore pa pagesë taksash, taksë rrugësh ose detyrimesh të tjera.

Privilegjet dhe imunitetet e Personelit Zviceran

13. Qeveria e Republikës së Shqipërisë i garanton Personelit Zviceran statusin, privilegjet dhe imunitetet siç parashikohen nga kjo Marrëveshje dhe në veçanti i garanton Personelit Zviceran të drejtën:

a) për të importuar jashtë detyrimeve ose kufizimeve të tjera, pajisje, materiale dhe mallra të tjera të cilat janë për përdorim ekskluziv dhe zyrtar nga Personeli Zviceran;

b) për t'u përjashtuar nga detyrimet doganore dhe akcizat e magazinimit, detyrimet ose kufizimet e tjera për pajisjet, materialet dhe mallrat e tjera, të cilat janë për përdorim ekskluziv dhe zyrtar nga Personeli Zviceran; dhe

c) për të rieksportuar pajisjet të cilat janë të përdorshme. Të gjitha materialet e pakonsumuara dhe mallrat e tjera të importuara ose të përjashtuara nga detyrimet doganore dhe akcizat e magazinimit, të cilat nuk transferohen ose janë të klasifikuara si të papërdorshme sipas afateve dhe kushteve që do të bihet dakord t'u dorëzohen autoriteteve vendore kompetente të Republikës së Shqipërisë ose ndonjë organi tjetër të ngarkuar prej tij.

14. Përpara se të kryhen proceset e importit, klirancave, transferimeve ose eksportimeve duke shmangur çdo vonesë, duhet të bihet dakord për procedura që kënaqin interesat reciproke sipas "Konceptit mbi përdorimin e EADRU në lehtësimin e pasojave të katastrofave ndërkombëtare" ndërmjet Personelit Zviceran dhe autoriteteve vendore të Republikës së Shqipërisë, sa më shpejt që të jetë e mundur.

V. LEHTËSIRAT PËR OPERIM

15. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër që në bashkëpunim me Zvicrën t'i sigurojë falas Personelit Zviceran zonat për ngritjen e shtabit, kampingut dhe objekte të tjera të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit operacional dhe administrativ, si edhe për akomodimin e pjesëtarëve të tij. Pa paragjykuar faktin se të tilla objekte ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër t'i trajtojë ato si subjekt i kontrollit dhe autoritetit ekskluziv të Kryetarit të Personelit Zviceran.

16. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër që brenda mundësive të saj të ndihmojë Personelin Zviceran në gjetjen dhe vënien në dispozicion atje ku është e mundur të ujit, energjisë elektrike dhe lehtësirave të tjera falas ose atje ku nuk është e mundur kundrejt çmimeve të arsyeshme dhe në rast të ndërprerjeve ose rrezikut të ndërprerjeve të këtyre shërbimeve t'i japë të njëjtin prioritet Personelit Zviceran me ato të shërbimeve kryesore qeveritare. Kur të tilla shërbime të dobishme nuk mund të sigurohen falas, Personeli Zviceran do të paguajë për këto shërbime mbi bazën e kushteve që do të bihet dakord me autoritetet kompetente. Personeli Zviceran do të ketë përgjegjësi për

mirëmbajtjen e këtyre impianteve pasi ato të jenë të disponueshme.

17. Personelit Zviceran do t'i jepet e drejta, atje ku shihet e nevojshme, për të gjeneruar energji elektrike për nevojat e tij, për ta transmetuar dhe shpërndarë këtë energji elektrike.

Procedurat në lidhje me blerjet e materialeve, mallrave dhe kujdesi shëndetësor

18. Republika e Shqipërisë merr përsipër të ndihmojë Personelin Zviceran brenda mundësive të saj për blerjet e pajisjeve, materialeve dhe mallrave e shërbimeve të tjera nga burimet vendore që kërkohen për jetesë e punë normale. Gjatë blerjeve në tregun vendor, Personeli Zviceran bazuar edhe në vëzhgimet e bëra nga vetë ai si edhe nga informacioni i dhënë nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në këtë aspekt do të shmangë çdo efekt negativ në ekonominë vendore. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do ta përjashtojë Personelin Zviceran nga taksat e blerjes për të gjitha blerjet vendore zyrtare.

19. Personeli Zviceran do të bashkëpunojë me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë në lidhje me shërbimet shëndetësore dhe çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin, veçanërisht në fushën e kontrollit të sëmundjeve të komunikueshme në përputhje me konventat ndërkombëtare.

Rekrutimi i personelit vendor

20. Personeli Zviceran mund të rekrutojë sipas nevojave të veta personel vendor. Me kërkesën e Kryetarit të Personelit Zviceran, Republika e Shqipërisë merr përsipër të lehtësojë rekrutimin e shtabit vendor të kualifikuar nga personeli Zviceran dhe të shpejtojë procesin e këtij rekrutimi.

VI. STATUSI I ANËTARËVE TË PERSONELIT ZVICERAN

Privilegjet dhe imunitetet

21. Republika e Shqipërisë do t'i garantojë privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat e nevojshme Kryetarit të Personelit Zviceran dhe anëtarëve të tjerë për të cilët Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka marrë njoftim dhe i ka pranuar.

22. Këto privilegje, imunitete dhe lehtësira përfshijnë:

(a) imunitet nga proceset ligjore, arrestimet dhe mbajtjet në izolim për fjalët që thuhen ose shkruhen, veprimet e kryera ose ato që nuk kryhen prej tyre në kapacitetin zyrtar dhe brenda kufijve të autoritetit të tyre;

(b) përjashtimet nga taksat, detyrimet ose të tjera pagesa, përveç atyre të cilat përfshihen normalisht në çmimet e mallrave ose pagesës për shërbimet e ofruara (të tilla si taksë për navigacionin ajror ose taksë aeroporti), që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare.

23. Anëtarët vendorë të rekrutuar të Personelit Zviceran do të gëzojnë imunitetet që lidhen me veprimet zyrtare të kryera në kuadër të operacionit, nëse në këtë Marrëveshje nuk ekziston ndonjë specifikim që e përjashton këtë.

24. Anëtarët e Personelit Zviceran do t'u garantohet e drejta për të importuar sendet e tyre personale, përjashtuar nga taksat, kur të mbërrijnë në Republikën e Shqipërisë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'u garantojë të gjithë anëtarëve të Personelit Zviceran lehtësira të veçanta që lidhen me procedura të shpejtuara të formaliteteve të hyrjes dhe daljes nga Republika e Shqipërisë.

25. Me largimin nga Republika e Shqipërisë, anëtarët e Personelit Zviceran pavarësisht nga rregullat e sipërpërmendura të shkëmbimit, mund të marrin me vete të hollat sipas një vërtetimi të lëshuar ngas Kryetari i Personelit Zviceran, që vërteton shumën që është marrë kur anëtarët e Personelit Zviceran kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë ose kur ato përbëjnë një mbetje të arsyeshme të hollash.

26. Kryetari i Personelit Zviceran do të bashkëpunojë me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe do të japë të gjithë ndihmesën brenda autoritetit të tij për të siguruar zbatimin e të gjitha rregullave doganore, ligjeve fiskale dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë nga anëtarët e personelit Zviceran në përputhje me këtë Marrëveshje.

E drejta e hyrjes, qëndrimit dhe largimit

27. Qeveria e Republikës së Shqipërisë i garanton anëtarëve të Personelit Zviceran të drejtën për të hyrë, qëndruar dhe larguar nga territori i saj.

28. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër të lehtësojë hyrjen dhe largimin nga territori i saj të anëtarëve të Personelit Zviceran dhe do të jetë vazhdimisht e informuar për këto lëvizje. Për këtë arsye, anëtarët e Personelit Zviceran do të përjashtohen nga rregullat e pasaportave dhe vizave, inspektimeve të imigracionit dhe kufizimeve mbi hyrjen ose largimin nga Republika e

Shqipërisë. Ata, gjithashtu do të përjashtohen nga çdo rregull që ka të bëjë me qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë duke përfshirë regjistrimin, por ata nuk do të fitojnë asnjë të drejtë për qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

29. Në lidhje me hyrjen dhe largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë, anëtarëve të Personelit Zviceran u kërkohet të kenë me vete:

(a) një urdhër lëvizjeje individual ose kolektiv të lëshuar nga /ose

nën autoritetin e Kryetarit të Personelit Zviceran ose të ndonjë autoriteti të përshtatshëm të shtetit Zviceran; dhe

(b) një kartë personale identiteti të lëshuar nga autoritetet kompetente Zvicerane.

Identifikimi

30. Kryetari i Personelit Zviceran do të pajisë të gjithë personelin vendor të rekrutuar me nga një kartë identiteti e cila do të përmbajë informacionin e mëposhtëm: emrin e plotë, datëlindjen, shërbimin dhe një fotografi.

31. Anëtarëve të Personelit Zviceran, si edhe personelit vendor të rekrutuar do t'u kërkohet të paraqesin kartën e tyre të identitetit me kërkesë të një zyrtari kompetent të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, por jo t'ia dorëzojnë atij.

Lejet dhe liçencat

32. Qeveria e Republikës së Shqipërisë bie dakord të pranojë si të vlefshme, jashtë taksave dhe detyrimeve të tjera financiare, një çertifikatë të lëshuar me kërkesë të Kryetarit të Personelit Zviceran që ka të bëjë me kualifikimin teknik dhe profesional të secilit prej anëtarëve të tij që ushtron një profesion ose një punë të ngjashme me të në lidhje me operacionin.

Mbajtja e disiplinës dhe ndihma reciproke

33. Kryetari i Personelit Zviceran do të marë të gjitha masat e nevojshme për të mbajtur disiplinën dhe rregullin ndërmjet anëtarëve të tij dhe personelit vendor të rekrutuar. Për këtë arsye Kryetari i Personelit Zviceran mund të caktojë personel që të merret me sigurinë fizike të objekteve të tij, si dhe zonave ku janë vendosur anëtarët e tij. Përveç këtyre zonave, ky personel mund të angazhohet vetëm në bazë të marrëveshjes me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe kur një angazhim i tillë është i nevojshëm për të mbajtur disiplinën dhe rregullin midis anëtarëve të Personelit Zviceran.

34. Personeli që përshkruhet në paragrafin 33 mund të izolojë çdo person të paautorizuar i gjetur në objektet e operacionit të Personelit Zviceran. Ky person duhet të dorëzohet menjëherë tek zyrtari kompetent më i afërt i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që ka për detyrë të merret me çdo shkelje ose prishje rendi në të tilla objekte.

35. Duke marrë parasysh përmbajtjen e paragrafit 22 më lart, zyrtarët e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mund të izolojnë çdo anëtar të Personelit Zviceran:

kur kjo kërkohet nga Kryetari i Personelit Zviceran; dhe

b) kur një anëtar i tillë i Personelit Zviceran është kapur në kryerje ose tentativë të kryerjes së një vepre penale. Ky person duhet t'i dorëzohet menjëherë së bashku me armën ose çdo send tjetër që zotëron, Kryetarit të Personelit Zviceran.

36. Personeli Zviceran dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të ndihmojnë njëri - tjetrin në kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme që lidhen me veprën penale, kur kjo është në interes të njërës palë ose të dy palëve së bashku.

37. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të sigurojë ndjekje ligjore sipas Kodit të saj Penal për personat të cilët akuzohen për vepra të kryera në lidhje me operacionin e Personelit Zviceran ose ndjekje për anëtarët e këtij Personeli që në qoftë se kryejnë vepra në lidhje me zyrtarët e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ato përbëjnë shkak për ndjekje ligjore.

VII. E DREJTA LIGJORE

38. Qeveria e Republikës së Shqipërisë u garanton të gjithë anëtarëve të Personelit Zviceran, duke përfshirë edhe personelin vendor të rekrutuar, imunitet nga proceset ligjore në lidhje me fjalët e thëna me gojë ose me shkrim dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e zyrtarit. I tillë imunitet do të vazhdojë edhe pasi ata pushojnë së qeni anëtarë ose të punësuar të Personelit Zviceran, si edhe pas shfuqizimit të kësaj Marrëveshjeje.

39. Nëse Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka të dhëna se ndonjë prej anëtarëve të Personelit

Zviceran ka kryer një vepër penale, ajo menjëherë duhet të informojë Kryetarin e Personelit Zviceran dhe t'i paraqesë atij provat e disponueshme.

40. Këshilli Federal Zviceran i jep sigurimet e tij Qeverisë së Republikës së Shqipërisë se ai do të ushtrojë të drejtën e tij ligjore në lidhje me shkeljet ose veprat penale që mund të kryhen nga Personeli Zviceran.

41. Nëse ndaj një anëtari të Personelit Zviceran ngrihet një çështje penale, civile përpara çdo gjykate të Republikës së Shqipërisë, Kryetari i Personelit Zviceran duhet të njoftohet menjëherë dhe atij duhet t'i vërtetohet nga gjykata nëse çështja penale lidhet ose jo me funksionet zyrtare të anëtarit.

42. Nëse Kryetari i Personelit Zviceran vërteton se çështja penale lidhet me funksionet zyrtare, kjo çështje duhet të ndërpritet dhe zbatohet përmbajtja e paragrafit 40 të kësaj Marrëveshjeje.

43. Nëse Kryetari i Personelit Zviceran vërteton se çështja penale nuk ka lidhje me funksionet zyrtare, kjo çështje mund të vazhdojë. Nëse ai vërteton se një anëtar i personelit të tij është i paaftë të mbrojë interesat e tij në gjykatë për shkak të funksioneve zyrtare ose të mungesës së autorizuar, gjykata sipas kërkesës së palës mbrojtëse e pezullon çështjen deri në eleminimin e mangësive, por jo më shumë se 90 ditë. Prona e anëtarit të Personelit Zviceran që vërtetohet nga Kryetari i tij si e domosdoshme për përmbushjen e funksioneve zyrtare të anëtarit nuk duhet të sekuestrohet për të kënaqur gjykimin, vendimin ose urdhrin. Liria personale e anëtarit të Personelit Zviceran nuk duhet të kufizohet në një çështje civile edhe kur imponohet një gjykim, vendim ose urdhër, kur detyrohet mbajtja e një betimi ose për asnjë arsye tjetër.

VIII. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

44. Përveç sa thuhet në paragrafin 51, çdo mosmarrëveshje ose pretendim ligjor i karakterit privat ndaj të cilit Personelit Zviceran ose ndonjë anëtar i përfshirë në këtë Marrëveshje është palë dhe mbi të cilin gjykata e Republikës së Shqipërisë nuk ushtron juridiksion për shkak të përmbajtjes së kësaj Marrëveshjeje, duhet të zgjidhen nga Komisioni i Ankesave, i cili do të ngrihet për këtë qëllim. Secila qeveri që përfshihet në këtë Marrëveshje do të zgjedhë nga një anëtar për komisionin, ndërsa Kryetari i Komisionit do të caktohet bashkërisht nga Kryetari i Zëvendësave të Këshillit të Atllantikut të Veriut dhe Qeveritë përfshirëse në këtë Marrëveshje.

45. Nëse brenda 30 ditëve nga emërimi i anëtarit të parë të Komisionit të Ankesave nuk është arritur ndonjë marrëveshje për zgjedhjen e kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s cakton kryetarin.

46. Çdo mungesë vendesh në Komisionin e Ankesave duhet të plotësohet nga e njëjta metodë e zbatuar për emërimet origjinale duke pasur parasysh se numërimi i 30 ditëve i përshkruar me sipër fillon menjëherë me mungesën e vendit.

47. Komisioni i Ankesave do të përcaktojë vetë procedurat e tij duke pasur parasysh që të dy anëtarët përbëjnë një grup për të gjitha çështjet (përjashtuar periudhën prej 30 ditësh pasi ndodh një mungesë) dhe të gjitha Vendimet do të kërkojnë aprovimin e të dy anëtarëve. Vendimet e Komisionit të Ankesave do të jenë të formës së prerë për t'u zbatuar, nëse ndonjë nga qeveritë përfshirëse në këtë Marrëveshje nuk apelon në një gjykatë të ndërtuar në përputhje me paragrafin 51. Vendimet e Komisionit të Ankesave do t'i njoftohen palëve dhe nëse ato janë kundër një anëtari të Personelit Zviceran, Kryetari i Personelit Zviceran ose Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar zbatimin e tyre.

48. Mosmarrëveshjet që lidhen me afatet e punësimit dhe kushtet e shërbimit të personelit vendor të rekrutuar do të zgjidhen sipas procedurave administrative që do të përcaktohen nga Kryetari i Personelit Zviceran.

49. Çdo mosmarrëveshje tjetër ndërmjet Personelit Zviceran dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe çdo apelim që të dyja palët do t'i bëjnë vendimeve të Komisionit të Ankesave të ndërtuar sipas paragrafit 46, për të cilat ato nuk bien dakord, do t'i paraqitet një gjykate me tre gjykatës. Përcaktimet që lidhen me formimin dhe procedurat e Komisionit të Ankesave do të zbatohen sipas ndryshimeve të nevojshme për formimin dhe procedurat e gjykatës.

50. Të gjitha mosmarrëveshjet që lidhen me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë do të zgjidhen me rrugë diplomatike.

IX. MARRËVESHJE SHTESË

51. Kryetari i Personelit Zviceran dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë mund të përfundojnë marrëveshje shtesë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

X. VENDOSJA E KONTAKTEVE

52. Kryetari i Personelit Zviceran dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të marrin masat e nevojshme për të siguruar kontakte të ngushta dhe reciproke në të gjitha nivelet e nevojshme.

XI. TË NDRYSHME

53. Kudo që kjo Marrëveshje i referohet privilegjeve, imuniteteve dhe të drejtave të garantuara Personelit Zviceran, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të ketë përgjegjësinë përfundimtare për zbatimin dhe përmbushjen e të tilla privilegjeve, imuniteteve, të drejtave dhe lehtësirave nga autoritetet vendore.

54. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi më 12 Nëntor 1999 dhe është e vlefshme për rrreth 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.

55. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në largimin e grupeve të fundit të Personelit Zviceran nga Republika e Shqipërisë, përjashtuar paragrafët 40, 42 dhe 43 të Seksionit VII, paragrafët 46 deri 52 të Seksionit VIII dhe paragrafin 54 në Seksionin XI, të cilët do të mbeten në fuqi deri sa të gjitha pretendimet, nëse ka, që janë ngritur përpara shfuqizimit të kësaj Marrëveshjeje dhe kanë qenë paraqitur përpara ose brenda tre muajve të këtij shfuqizimi janë zgjidhur.

E bërë në Tiranë, më 10 nëntor 1999, në dy kopje, në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë	Për Këshillin Federal Zviceran
Ministri i Mbrojtjes	Ambasadori
Luan HAJDARAGA	Thomas FELLER

L I G J
Nr.8575, datë 3.2.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7932, DATË 17.5.1995, ME LIGJIN NR.8286, DATË 16.2.1998 DHE ME LIGJIN NR.8392, DATË 2.9.1998

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995, me ligjin nr.8286, datë 16.2.1998 dhe me ligjin nr.8392, datë 2.9.1998 bëhet ky ndryshim:

"Në nenin 96 paragrafi 3, fjalia: "Këtë të drejtë ata e ushtrojnë deri në një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji." zëvendësohet me fjalinë: "Këtë të drejtë ata e ushtrojnë deri më datën 30 qershor

2000.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2548, datë 10.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8576, datë 3.2.2000

PËR BIBLIOTEKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe normave themelore të veprimtarisë së bibliotekave dhe të zhvillimit të gjithë sistemit bibliotekar. Ky ligj e shtrin veprimin e vet në të gjithë rrjetin e bibliotekave që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga forma e pronës dhe përkatësia institucionale.

2. Bibliotekat bëjnë pjesë në sistemin kombëtar të informacionit.

Neni 2

Bibliotekat janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.

Neni 3

Rrjeti kombëtar bibliotekar përbëhet nga tërësia e bibliotekave të Republikës së Shqipërisë dhe funksionon në bashkëpunim me rrjetin e arkivave dhe atë të muzeve, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 4

Veprimtaria e rrjetit të bibliotekave realizohet nëpërmjet:

përpunimit standard të materialeve bibliotekare;

b) përgatitjes dhe shpërndarjes së informacionit bibliotekar-bibliografik;

c) krijimit dhe mirëmbajtjes së katalogëve përmbledhës të pasurisë bibliotekare kombëtare dhe asaj të huaj;

ç) shkëmbimit dhe huazimit ndërbibliotekar.

Neni 5

Çdo person ose grup personash fizikë e juridikë, vendas ose të huaj kanë të drejtë të krijojnë bibliotekë me karakter publik apo të specializuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet në fuqi.

KREU II
TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E SHTETASVE PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE BIBLIOTEKARE

Neni 6

Çdo shtetas në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga raca, mosha, seksi, kombësia, formimi arsimor e kulturor, gjendja sociale, bindjet politike dhe përkatësia fetare ka të drejtën e shërbimit bibliotekar.

Neni 7

Përdoruesi i bibliotekës ka të drejtë:

a) të marrë informacion për koleksionet e bibliotekës dhe për koleksionet e bibliotekave të tjera nëpërmjet mjeteve tradicionale dhe elektronike të informacionit bibliotekar;

b) të ndihmohet për kërkim dhe zgjedhje të botimeve informative;

c) të shfrytëzojë koleksionet e bibliotekës në mjediset e saj, të fotokopjojë dhe të huazojë materiale bibliotekare, sipas rregullores së bibliotekës;

ç) të huazojë materiale ose fotokopje të tyre nga bibliotekat e tjera brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet shërbimit ndërbibliotekar.

Neni 8

E drejta për shërbim dhe informacion bibliotekar sigurohet falas dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e bibliotekave shtetërore. Tarifat e shërbimit bibliotekar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të bibliotekës përcaktohen në rregulloren e saj, që miratohet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 9

Përdoruesit detyrohen të respektojnë rregulloren e bibliotekës.

Ata që shkelin këtë rregullore dhe sjellin dëm material dhe ekonomik, e shlyejnë atë në masën dhe në formën e duhur, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU III
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E SHTETIT NË FUSHËN E BIBLIOTEKAVE

Neni 10

Shteti garanton mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dokumentare sipas ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat” dhe ligjit nr.7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore”, si dhe sipas konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat ai është palë.

Neni 11

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve harton dhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, në përputhje me politikën kulturore të Shtetit Shqiptar.

Neni 12

1. Ministritë, organet e pushtetit vendor dhe institucionet qendrore përcaktojnë politikën financiare të bibliotekave të sistemit të tyre përkatës.

2. Këto japin mbështetje financiare për realizimin e projekteve dhe të programeve të bibliotekave të propozuara nga vetë bibliotekat, shoqatat profesionale të punonjësve të bibliotekave, si dhe nga individë.

Neni 13

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve orienton dhe mbikëqyr veprimtarinë profesionale në të gjithë rrjetin bibliotekar të vendit.

2. Rregullat, udhëzimet dhe urdhëresat të nxjerra prej kësaj ministrie, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, janë të detyrueshme për të gjithë rrjetin e bibliotekave të vendit.

Neni 14

Pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve funksionon Këshilli Kombëtar i Bibliotekave. Ai është një organ këshillimor, i cili përbëhet nga:

1. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe SporteveKryetar
2. Drejtori i Bibliotekës KombëtareAnëtar
3. Një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “
4. Një përfaqësues i Akademisë së Shkencave “
5. Kryetari i Shoqatës së Bibliotekave të Shqipërisë “
6. Një përfaqësues i Ministrisë së Pushtetit Vendor “
7. Një përfaqësues i Ministrisë së Financave “
8. Kryetari i Shoqatës së Botuesve të Shqipërisë “
9. Një përfaqësues nga bibliotekat publike vendore “
10. Një përfaqësues ngas Qendra Kombëtare e Informacionit “
11. Një përfaqësues nga bibliotekat universitare “
12. Drejtori i Drejtorisë së Librit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve

Sesionet e Këshillit mbahen sipas rregullores së brendshme të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

KREU IV
DETYRAT E BIBLIOTEKAVE

Neni 15

Bibliotekat krijojnë dhe pasurojnë koleksionet e tyre mbi bazën e një gjykimi të pavarur profesional, në këshillim me mendimin e përdoruesve dhe të institucioneve të tjera kulturore, shkencore, edukative dhe informuese.

Neni 16

1. Koleksionet e bibliotekave, që përbëjnë trashëgiminë kulturore dokumentare, janë pjesë e pasurisë kulturore kombëtare.

Ato përbëhen nga materiale të shtypura dhe grafike, materiale audovizuale dhe elektronike,

dorëshkrime etj.

2. Si dokumente të trashëgimisë kulturore, koleksionet e bibliotekave përfshihen në listën e objekteve që mbrohen nga rregulla të posaçme eksportimi.

3. Eksportimi i tyre i përhershëm është i ndaluar. Lejohet vetëm transferta ndërkufitare e përkohshme e tyre, sipas ligjeve shtetërore në fuqi.

Neni 17

Koleksionet e bibliotekave, me materiale shqip e në gjuhë të huaja, krijohen dhe pasurohen nëpërmjet blerjes, shkëmbimit dhe dhuratave.

Neni 18

Bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe të dikastereve të tjera nga të cilat ato varen, bibliotekat:

- bëjnë spastrimin e materialeve të vjetëruara e që nuk qarkullojnë, nëpërmjet heqjes nga koleksionet e tyre të këtyre materialeve, në përputhje me rregullat financiare;
- bëjnë regjistrimin e materialeve bibliotekare dhe i përpunojnë ato sipas rregullave që bazohen në standarde ndërkombëtare të përpunimit bibliotekar-bibliografik;
- sigurojnë informacion për lexuesit nëpërmjet katalogëve, bibliografive, mjeteve elektronike etj.;
- vënë në shërbim të lexuesve koleksionet e bibliotekës në sallat e leximit ose i huazojnë jashtë saj, bazuar në rregullore;
- kryejnë marrëdhënie shkëmbimi e huazimi me bibliotekat e tjera të vendit në shërbim të plotësimit të kërkesave të lexuesve;
- u krijojnë kushte përdoruesve të fotokopjojnë materiale të bibliotekës, duke respektuar ligjin e të drejtës së autorit, si dhe rregulloren e bibliotekës;
- krijojnë kushte për shfrytëzimin e bibliotekës nga kategori të veçanta lexuesish si fëmijë, persona me aftësi të kufizuar etj.

Neni 19

Bibliotekat hyjnë në marrëdhënie shkëmbimi dhe huazimi me bibliotekat homologe në përputhje me rregullat e bashkëpunimit bibliotekar ndërkombëtar.

Neni 20

Ndalohet përdorimi i mjediseve të bibliotekave shtetërore për veprimtari partiake ose në shërbim të organizatave politike.

KREU V
ORGANIZIMI I BIBLIOTEKAVE

Neni 21

1. Detyrat dhe sfera e veprimtarisë së bibliotekës përcaktohen në statutin dhe rregulloren e saj, të miratuar nga personi fizik a juridik që e ka krijuar.

2. Organizimi i brendshëm i bibliotekës përcaktohet në rregulloren e miratuar nga drejtuesi i saj (drejtor ose përgjegjës).

Neni 22

Emërimi dhe lirimi nga funksioni i drejtuesit të bibliotekës bëhet nga organi që ka në varësi bibliotekën.

Neni 23

Drejtuesi përgjigjet për funksionimin dhe drejtimin e bibliotekës. Ai ka për detyrë:

të përcaktojë strukturën e bibliotekës;

b) të emërojë punonjësit specialistë dhe të administratës, në përputhje me organikën e përgjithshme dhe kriteret e përcaktuara nga organi epror;

c) të përgjigjet për veprimtarinë financiare të institucionit;

ç) të përcaktojë politikat e pasurimit të koleksioneve të bibliotekës. Të sigurojë informacione mbi to dhe shfrytëzimin e tyre;

d) të krijojë kushte për shërbimet bibliotekare dhe informuese.

Neni 24

1. Biblioteka ka këshillin e saj si organ funksional këshillimor të drejtuesit. Këshilli jep mendime për organizimin, veprimtarinë, shërbimet bibliotekare dhe informuese, si dhe për probleme të tjera që kanë të bëjnë me anën profesionale.

2. Në përbërje të këshillit janë drejtuesit, punonjës të bibliotekës dhe specialistë të njohur në veprimtarinë kulturore e shkencore, të miratuar nga titullari.

Neni 25

1. Organi, që ka në varësi bibliotekën, financon dhe ushtron kontroll për përdorimin e fondeve të dhëna.

2. Bibliotekat mund të përfitojnë nga burime të tjera financiare si ndihma nga fondacione, organizata shoqërore vendase dhe të huaja.

3. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet për persona të tretë administrohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU VI
LLOJET E BIBLIOTEKAVE

Neni 26

Bibliotekat janë:

1.Publike shtetërore

2. Publike private

Bibliotekat publike shtetërore, bazuar në funksionet, veprimtarinë dhe varësinë, klasifikohen në këto lloje:

- Biblioteka Kombëtare
- Biblioteka publike vendore
- Biblioteka të veçanta
- Biblioteka universitare e të shkollave të larta
- Biblioteka shkollore

Neni 27

Biblioteka Kombëtare

Biblioteka Kombëtare, me seli në Tiranë, është institucioni bibliotekar kryesor i vendit, si dhe qendër studimore shkencore.

Ajo organizohet dhe funksionon nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Biblioteka Kombëtare kryen këto funksione:

1. Është institucion depozitues i kopjes së detyruar, ku përfshihen të gjitha llojet e informacionit, në cilëndo formë të jetë i regjistruar.

Nëpërmjet kopjes së detyruar sigurohet:

a) krijimi dhe pasurimi i arkivit kombëtar me botime të formave të ndryshme me qëllim ruajtjen, transmetimin dhe zhvillimin e kulturës kombëtare për brezat e ardhshëm;

hartimi dhe botimi i bibliografisë kombëtare;

shfrytëzimi i botimeve të depozituara.

2. Grumbullon, pasuron, përpunon, ruan dhe vë në shërbim të përdoruesve botimet në gjuhën shqipe, si dhe botime në gjuhë të huaj që përmbajnë informacion për Shqipërinë dhe kombin shqiptar dhe përbëjnë koleksionin albano – balkanologjik.

3. Grumbullon, pasuron, përpunon, ruan dhe vë në shërbim të përdoruesve koleksione të literaturës botërore të karakterit të përgjithshëm.

4. Është qendra e përgatitjes dhe e shërbimit të informacionit bibliografik kombëtar.

Kryen kontrollin bibliografik, përgatit dhe boton bibliografinë kombëtare e bibliografi korrente e perspektive të llojeve të ndryshme.

5. Është qendra kryesore e ruajtjes, përpunimit dhe dhënies së informacionit albano – balkanologjik.

6. Është qendër e krijimit dhe e mirëmbajtjes së katalogut përmbledhës kombëtar dhe merr pjesë në rrjetin ndërkombëtar të informacionit bibliotekar.

7. Kryen katalogizimin e librit për botim.

8. Kryen formimin dhe kualifikimin profesional të punonjësve të bibliotekave të vendit.

9. Është qendër e studimeve në fushën e bibliotekonomisë, bibliografisë dhe të shkencës së informacionit dhe punon për zhvillimin e këtyre fushave.

10. Është qendër metodike për zbatimin e standardeve dhe rekomandimeve të organizatave dhe organizmave përkatës ndërkombëtarë në tërë veprimtarinë bibliotekare.

11. Është qendër e restaurimit të materialeve bibliotekare që klasifikohen si trashëgimi kombëtare kulturore dokumentare.

Për të realizuar pasurimin e koleksioneve me vlerë kombëtare, Biblioteka Kombëtare kryen blerje me fonde buxhetore të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 28

Bibliotekat publike vendore

1. Janë institucione vendore, kulturore dhe informuese, që nxisin të mësuarit, zgjerimin e dijeve dhe interesin për lexim në rajonin ku ato zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Si institucione publike ato mbështesin pjesëtarët e bashkësisë, së cilës i shërbejnë, që të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike dhe të luajnë rol aktiv në shoqëri.

2. Krijohen në çdo bashki dhe komunë. Ato janë në varësi administrative të organeve të pushtetit vendor në rajonin e të cilave zhvillojnë veprimtarinë.

3. Organet shtetërore vendore sigurojnë shërbim bibliotekar për popullsinë në ndarjet territoriale që janë në juridiksionin e tyre. Ato sigurojnë mjediset e bibliotekave sipas normativave të shërbimit të lexuesve dhe sasisë së koleksioneve, si dhe mjetet e pajisjet për zhvillim normal të veprimtarisë bibliotekare.

4. Drejtuesi i bibliotekës publike vendore emërohet nga organet e pushtetit vendor, në varësi të të cilit është biblioteka, bazuar në kriteret e caktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Ai duhet të jetë bibliotekar i kualifikuar profesionalisht.

5. Krijimi dhe shpërndarja e bibliotekave publike vendore, si dhe numri i punonjësve të tyre, caktohen sipas normativave të hartuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor.

6. Koleksionet e bibliotekave publike vendore përmbajnë literaturë të karakterit të përgjithshëm të të gjitha fushave të diturisë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, si në formë të

shtypur, ashtu dhe elektronike, me përparësi fushat për të cilat ka më shumë interes rajoni, ku biblioteka zhvillon veprimtarinë.

7. Bibliotekat publike vendore përhapin informacion me burim pushtetin qendror dhe atë vendor, si dhe çdo informacion tjetër me karakter publik nga burime të tjera.

8. Ato krijojnë katalogë dhe sigurojnë informacion të materialeve bibliotekare me karakter historik, kulturor, shkencor etj., për territorin ku ato zhvillojnë veprimtarinë.

9. Organizojnë shërbime të veçanta për anëtarë të bashkësisë që, për arsye të ndryshme, nuk kanë mundësi të përdorin shërbimet e zakonshme si: njerëzit me aftësi të kufizuara, të sëmurët, minoritetet gjuhësore, banorët e zonave të largëta ose pak të populluara, të burgosurit etj.

10. Në varësi të koleksioneve, numrit të përdoruesve, si dhe të shërbimeve bibliotekare dhe informuese që kryejnë, bibliotekat publike vendore kategorizohen në dy nivele nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Bibliotekat e komunave përbëjnë kategorinë e tretë të sistemit të bibliotekave publike.

11. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor, cakton në çdo prefekturë një bibliotekë që luan rolin e bibliotekës qendrore për bibliotekat e tjera të bashkive dhe komunave të saj.

Neni 29

Bibliotekat e veçanta

1. Krijohen dhe funksionojnë nën autoritetin e organeve qendrore, të dikastereve, Akademisë së Shkencave, institucioneve kërkimore – shkencore, institucioneve të kulturës, institucioneve fetare, qendrave ekonomike e shëndetësore, sociale dhe edukative, të ushtrisë e rendit, organizatave, fondacioneve, shoqatave, firmave dhe kompanive të ndryshme.

2. Grumbullojnë, përpunojnë dhe shërbejnë materiale bibliotekare dhe informacion sipas kërkesave e nevojave të personave fizikë e juridikë në varësi të të cilëve janë.

3. Drejtuesi dhe punonjësit emërohen nga titullari i subjektit që ka në varësi bibliotekën.

Neni 30

Bibliotekat e universiteteve dhe të shkollave të tjera të larta

1. Çdo universitet dhe shkollë tjetër e lartë krijon bibliotekën e vet. Bibliotekat e universiteteve dhe të shkollave të tjera të larta janë në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore të këtyre institucioneve.

2. Ato grumbullojnë, përpunojnë, ruajnë dhe venë në shërbim të përdoruesve materiale bibliotekare në përshtatje me kërkesat arsimore, shkencore dhe kulturore të tyre.

Sigurojnë shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës.

3. Bibliotekat universitare krijojnë degë të tyre në fakultete e departamente me miratimin e organit që i ka në varësi.

4. Kryen formim dhe kualifikim të posaçëm.

Neni 31

Bibliotekat e shkollave

1. Bibliotekat e shkollave tetëvjeçare e të mesme janë në shërbim të realizimit të programeve mësimore dhe edukative, si dhe të formimit profesional të punonjësve të arsimit.

2. Konceptimi, administrimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së bibliotekave shkollore sigurohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes drejtorive arsimore në rrethe dhe bashki.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 33

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2555, datë 14.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8577, datë 10.2.2000

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 6, 81, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, statusin e gjyqtarit, paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre.
2. Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.

Neni 2
Funksioni i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën

interpretimin përfundimtar të saj.

Neni 3
Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.
2. Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

Neni 4
Selia e Gjykatës Kushtetuese

Selia e Gjykatës Kushtetuese është në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Neni 5
Simbolet që vendosen në Gjykatën Kushtetuese

1. Në sallën e Gjykatës Kushtetuese vendoset Stema e Republikës së Shqipërisë, Flamuri Kombëtar dhe një pamje e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.
2. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjatë zhvillimit të seancës plenare, mban një veshje të veçantë; përshkrimi dhe forma e së cilës përcaktohet nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 6
Mjetet financiare

1. Gjykata Kushtetuese administron buxhetin e saj, i cili si pjesë e buxhetit të shtetit, hartohet prej saj dhe i paraqitet për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
2. Në mjetet financiare përfshihet edhe çdo e ardhur tjetër që nuk është e ndaluar me ligj.
3. Llogaritë financiare të Gjykatës Kushtetuese kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

KREU II
ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 7
Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.
2. Gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, nga radhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.
3. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet në një të tretën e saj, sipas procedurës së caktuar në këtë ligj.
4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh, me të drejtë riemërimi brenda mandatit të gjyqtarit.

Neni 8
Fillimi i detyrës

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
2. Formula e betimit është: “Betohem se gjatë kryerjes së detyrave të mia do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”.

3. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

4. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.

Neni 9
Mbarimi i mandatit

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:

a) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

b) nuk paraqitet pa arsye në detyrë për më shumë se 6 muaj;

c) mbush moshën 70 vjeç;

ç) jep dorëheqjen;

d) me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paaftë për të vepruar.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit emëron një gjyqtar të ri brenda 1 muaji, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

Neni 10
Shkarkimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore apo fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

2. Procedura e shqyrtimit të Kuvendit për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, fillon me kërkesë të motivuar të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 11
Drejtimi i Gjykatës Kushtetuese

Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese drejtohet dhe organizohet nga Kryetari i saj dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej gjyqtarëve të caktuar prej tij, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj është përcaktuar në kompetencë të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

Neni 12
Kompetencat e Kryetarit

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

a) Përgatit, thërret e drejton seancat plenare të Gjykatës Kushtetuese.

b) Përfaqëson Gjykatën Kushtetuese në marrëdhënie me të tretët.

c) Bashkërendon punën midis gjyqtarëve.

ç) Nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të vendimeve që nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët.

d) Emëron dhe largon nga detyra personelin administrativ, si dhe merr masa disiplinore ndaj tij.

Neni 13
Kompetencat e Mbledhjes së Gjyqtarëve

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

a) Përcakton drejtimet kryesore të shpenzimeve të mjeteve buxhetore.
b) Informohet çdo 6 muaj me raporte për shpenzimet buxhetore.
c) Vendos për strukturën organizative të Gjykatës Kushtetuese.
ç) Vendos për numrin e personelit dhe pagat e tyre.
d) Miraton rregulloren e brendshme për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 14
Nëpunësit civilë

1. Nëpunësi më i lartë civil në Gjykatën Kushtetuese është Sekretari i Përgjithshëm.
2. Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese kryhen nga nëpunës dhe punonjës të tjerë.
3. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga radhët e juristëve me përvojë profesionale.
4. Sekretari i Përgjithshëm drejton veprimtarinë administrative të Gjykatës Kushtetuese, nën autoritetin e Kryetarit të saj.
5. Të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve e punonjësve të tjerë të shërbimeve përcaktohen nga ky ligj dhe Rregullorja e Brendshme.
6. Punonjësit e administratës së Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të shërbimit civil dhe trajtohen financiarisht njëlloj si punonjësit e administratës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15
Garantimi i rendit

1. Për mbajtjen e rendit dhe ruajtjen e saj, Gjykata Kushtetuese ka të drejtën e disponimit të forcave policore që vihen në shërbim të saj.
2. Numri dhe detyrat e këtyre forcave policore miratohen nga Ministri i Rendit Publik me propozimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

KREU III
STATUSI I GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 16
Imuniteti

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë paprekshmëri për gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk mbajnë përgjegjësi ligjore për mendimet ose votën e shprehur për çështje në shqyrtim.
2. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndiqet penalisht pa pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.
3. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që merret me shumicën e votave, duhet të jetë i arsyetuar. Gjyqtari, për të cilin kërkohet pëlqimi, pasi dëgjohet, nuk merr pjesë në votim.

Neni 17
Paga

1. Paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.
2. Paga e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese është 20 për qind më e lartë se paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

3. Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ulen dhe as të preken.

Neni 18

Të drejta të tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet:

a) të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze ose çmohet se është e domosdoshme. Organet përkatëse, të ngarkuara me ruajtjen e personaliteteve të larta, janë të detyruara t'i përgjigjen çdo kërkese të bërë në këtë drejtim;

b) të përfitojnë leje të pagueshme vjetore 40 ditë. Leja vjetore bëhet gjatë muajit gusht-shtator;

c) të përfitojnë falas Fletoren Zyrtare, gazeta dhe revista juridike;

ç) të përfitojnë në mënyrë të barabartë po ato të drejta që gëzojnë deputetët, sipas neneve 16 pika 1, 19, 20, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit".

2. Koha e qëndrimit në detyrë e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e përmendura në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

3. Në përfundim të mandatit, me përjashtim të rastit kur shkarkohet nga detyra sipas procedurave të përcaktuara në ligj, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese caktohet në një detyrë tjetër të barabartë ose të përafërt, si dhe përfiton pagesë kalimtare dhe/ose pension suplementar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19

Marrëdhëniet protokollare

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e saj kanë status të veçantë protokollar.

2. Në marrëdhëniet protokollare Kryetari i Gjykatës Kushtetuese vjen menjëherë pas Kryeministrit, ndërsa gjyqtarët e saj barazohen në trajtimin protokollar me ministrin.

3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ftohen të marrin pjesë në delegacionet zyrtare, ceremonitë, pritjet dhe veprimtaritë e ndryshme të karakterit kulturor, shoqëror dhe sportiv, sipas protokollit të përcaktuar në këtë nen.

KREU IV

PARIME TË GJYKIMIT KUSHTETUES

Neni 20

Shqyrtimi kolegjial

Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet kolegjialisht. Vendimi merret vetëm nga ata gjyqtarë që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.

Neni 21

Procesi publik

1. Shqyrtimi i çështjeve në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese bëhet i hapur.

2. Gjykata Kushtetuese mund ta përjashtojë publikun nga seanca plenare ose një pjesë të tij, me arsyetimin e mbrojtjes së moralit publik, të rendit publik, të sigurisë kombëtare, të së drejtës së jetës private ose të së drejtave vetjake.

Neni 22

Përdorimi i gjuhës shqipe

1. Në shqyrtimin e çështjeve përdoret gjuha shqipe.

2. Pjesëmarrësit në gjykim, që nuk dinë gjuhën shqipe, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për të gjithë zhvillimin e procesit me anë të përkthyesit, që si rregull sigurohet nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 23
Procesi gojor

Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet gojarisht ose mbi bazë dokumentash, sipas natyrës së çështjes.

Neni 24
Mbrojtja në gjykimin kushtetues

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit, në mënyrën e parashikuar në këtë ligj.

Neni 25
Paanësia në gjykimin kushtetues

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve është i paanshëm dhe bazohet në kryerjen e detyrave të tij vetëm në Kushtetutë dhe në ligj.
2. Në veprimtarinë e tij, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese merr pjesë me cilësinë e tij vetjake dhe nuk përfaqëson asnjë organ shtetëror, organizatë shoqërore, parti ose shoqatë politike, grup etnik ose social.

Neni 26
Publikimi i vendimit përfundimtar

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare. Ato botohen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të saj. Kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij.
2. Organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi.
3. Gjykata Kushtetuese çdo vit përgatit një përmbledhje të vendimeve të saj.

KREU V
PARAQITJA DHE SHQYRTIMI PARAPRAK I KËRKESËS

Neni 27
Regjistrimi i kërkesës

1. Kërkesa që drejtohet në Gjykatën Kushtetuese regjistrohet menjëherë në regjistrin e posaçëm që mban kryesekretaria e Gjykatës Kushtetuese.
2. Kërkesa i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili cakton një relator që përgatit çështjen për shqyrtimin paraprak të saj.

Neni 28
Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit dhe duhet të përmbajë:
a) emrin e gjykatës përpara të cilës paraqitet;
b) emrin, mbiemrin (emërtimin), vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuesit;
c) emrin, mbiemrin (emërtimin), vendbanimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara;
ç) objektin e kërkesës;

d) përmbajtjen e kërkesës dhe parashtrimin e shkaqeve;
dh) treguesin e dokumenteve dhe mjeteve të tjera provuese që shoqërojnë kërkesën;
e) nënshkrimin e kërkuesit ose të përfaqësuesit të tij.
2. Kërkesa u njoftohet palëve në gjykim.

Neni 29
Dokumente që i bashkëlidhen kërkesës

1. Sipas rastit, kërkesës i bashkëlidhen këto dokumente:
a) Akti i përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi.
b) Kopje të aktit që është objekt i kërkesës.
c) Dokumente origjinale ose të noterizuara, ose prova shkresore që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.
2. Kopje të aktit, të dokumentit ose të provave shkresore paraqiten në numër sa janë pjesëmarrësit në gjykim, që t'u njoftohen atyre.

Neni 30
Afati i paraqitjes së kërkesës

1. Për paraqitjen e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese zbatohen afatet e përcaktuara në këtë ligj.
2. Kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes. Kur në bazë të ligjit individi mund t'i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në këtë rast, afati i paraqitjes së kërkesës është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror.

Neni 31
Shqyrtimi paraprak i kërkesës

1. Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori.
2. Kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë, kolegji ia kthen kërkuesit për plotësim, duke treguar shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj. Pas kësaj, kur kërkesa paraqitet e plotësuar, kalon përsëri për shqyrtim paraprak në kolegj. Kërkesa e paplotësuar nuk merret në shqyrtim.
3. Kur kërkesa është paraqitur nga subjekti që legjitimohet dhe çështja është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos kalimin e çështjes në seancë plenare, ndërsa kur ajo nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet ose çështja nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve, e cila vendos me shumicë votash për kalimin ose jo të çështjes në seancë plenare.
4. Në të gjitha rastet e mësipërme, kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton zgjidhjen në themel të çështjes.
5. Për ankesat, lutjet dhe çdo korrespondencë tjetër që nuk përmban elementet e kërkesës, në kuptim të nenit 28 të këtij ligji, veprohet administrativisht.

KREU VI
FUNKSIONIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 32
Shqyrtimi në seancë plenare

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton çështjen në seancë plenare.

2. Në seancë plenare marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast jo më pak se dy të tretat e tyre.

Neni 33
Thirrja dhe drejtimi i seancës plenare

1. Seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese e thërret dhe e drejton Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

2. Me miratimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, seancën plenare mund ta thërrasë dhe ta drejtojë një gjyqtar i saj.

Neni 34
Të drejtat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë:

a) të marrë pjesë në shqyrtimin e çdo çështjeje, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga ligji;

b) të njihet me përmbajtjen dhe gjithë materialet e çështjes në shqyrtim;

c) gjatë shqyrtimit, t'u drejtojë pyetje e të kërkojë shpjegime nga pjesëmarrësit në gjykim, si dhe nga personat e thirrur si dëshmitarë ose ekspert;

ç) të marrë pjesë në bisedimet përfundimtare dhe të shfaqë lirisht mendimin e tij për mënyrën e përfundimit të çështjes që shqyrtohet.

Neni 35
Detyrat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese duhet:

a) të përgatisë çështjen për gjykim, si dhe të marrë masat e duhura për zhvillimin e seancës plenare;

b) të votojë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes;

c) të ruajë sekretin e diskutimeve dhe të votimit.

Neni 36
Heqja dorë nga shqyrtimi i çështjes

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese është i detyruar të heqë dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur:

a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi;

b) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim vihet në dyshim objektiviteti i tij;

c) në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie.

2. Heqja dorë miratohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, derisa çështja nuk ka kaluar në seancë plenare. Më pas, heqja dorë vendoset me shumicën e votave të gjyqtarëve pjesëmarrës në proces.

Neni 37
Përjashtimi i gjyqtarit

1. Pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit në çdo fazë të zhvillimit të gjykimit kur ekziston një nga rastet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe gjyqtari nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Për përjashtimin e gjyqtarit vendos shumica e gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes. Gjyqtari, për të cilin kërkohet përjashtimi, pasi dëgjohet nuk merr pjesë në votim. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, gjyqtari quhet i përjashtuar.

Neni 38
Njoftimi dhe pjesëmarrja në seancë plenare

1. Për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare duhet të njoftohet kërkuesi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre.

2. Njoftimi bëhet nga kryesekretaria e Gjykatës Kushtetuese të paktën 10 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare.

3. Njoftimi bëhet me shkresë zyrtare, me fletë-thirrje postare dhe në raste të ngutshme me telegram ose me faks, që i dorëzohen palëve ose anëtarëve madhorë të familjes. Kur ndonjë nga pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues nuk i dihet vendqëndrimi ose ndodhet me qëndrim të përhershëm jashtë shtetit, njoftimi bëhet me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese, të paktën 1 muaj përpara datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare.

4. Në seancë plenare marrin pjesë kërkuesi, subjekti i interesuar, përfaqësuesit e tyre dhe dëshmitarët ose ekspertët kur ka të tillë.

5. Mungesa e njoftimit shkakton shtyrjen e seancës plenare, duke caktuar një datë tjetër për zhvillimin e saj, si dhe duke bërë njoftimet përkatëse.

6. Kur kërkuesi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre, megjithëse janë njoftuar, nuk paraqiten në seancë plenare dhe për këtë nuk kanë paraqitur shkaqe të përligjura, seanca plenare zhvillohet në mungesë.

Neni 39
Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues

1. Pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë:

a) Subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij.

b) Subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtëpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet.

c) Organi që ka nxjerrë aktin.

ç) Organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë.

2. Në rastet kur pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë organe shtetërore, ato përfaqësohen nga drejtuesit e tyre dhe në mungesë nga persona të autorizuar me shkrim.

3. Përfaqësues të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues mund të jenë avokatët, të cilët pajisen me prokurë ose caktohen si të tillë me deklarim në seancë plenare.

4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë cakton listën e avokatëve që mund të marrin pjesë në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 40
Thirrja e ekspertit

1. Me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë me cilësinë e ekspertit persona që kanë njohuri të posaçme në fushën e shkencës, teknikës ose artit për konstatimin dhe sqarimin e fakteve që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

2. Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet edhe në seancë plenare.

Neni 41
Thirrja e dëshmitarit

Kur shihet e domosdoshme për sqarimin e fakteve që lidhen me çështjen në shqyrtim, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë e të pyesë në seancë plenare persona me cilësinë e dëshmitarit.

Neni 42
Kërkimi i dokumenteve

1. Kur shihet e domosdoshme, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të kërkojë dokumente të cilat kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

2. Dokumentet e kërkuara administrohen në seancë plenare.

Neni 43
Zhvillimi i seancës plenare

Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare ndjek këto rregulla:

a) Deklarohet çelja e seancës plenare nga kryesuesi i saj.

b) Verifikohet paraqitja e pjesëmarrësve.

c) Verifikohet legjitimiteti i pjesëmarrësve ose i përfaqësuesve të tyre.

ç) Pyeten pjesëmarrësit nëse kanë kërkesa paraprake dhe vendoset për to.

d) Lexohet kërkesa nga gjyqtari relator.

dh) Ftohen pjesëmarrësit të parashtrojnë kërkesat dhe kundërshtimet, duke filluar nga subjekti që ka paraqitur kërkesën.

e) Pjesëmarrësit në proces japin shpjegime ose bëjnë sqarime për pyetjet e gjyqtarëve.

ë) Administrohen provat dhe ftohen pjesëmarrësit të japin mendime për përmbajtjen e tyre.

f) Ftohen pjesëmarrësit të bëjnë kërkesat përfundimtare.

g) Deklarohet nga kryesuesi mbyllja e seancës plenare dhe tërheqja për vendim.

Neni 44
Riçelja e seancës plenare

1. Nëse pas mbylljes të seancës plenare çmohet e domosdoshme sqarimi i rrethanave plotësuese, të cilat kanë rëndësi të veçantë për çështjen në shqyrtim, vendoset riçelja e saj.

2. Vendimi për riçeljen e seancës plenare merret me shumicë votash nga gjyqtarët që kanë qenë të pranishëm në seancën plenare.

3. Vendimi për riçeljen e seancës plenare u njoftohet pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në të dhe t'u jepet fjala nëse e kërkojnë, për të bërë shpjegime që i çmojnë në interes të tyre.

Neni 45
E drejta për pezullim

1. Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

2. Vendimi për masën e pezullimit i njoftohet organit përkatës që ka nxjerrë ligjin ose aktin, si dhe bëhet publikimi i tij.

3. Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, me vendim në seancën plenare, mund të heqë masën e pezullimit.

4. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit.

Neni 46
Procesverbali i seancës plenare

Në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese mbahet procesverbal, i cili, në përfundim të saj, nënshkruhet nga kryesuesi i seancës plenare dhe sekretari që e mban atë.

Neni 47
Afati i fillimit të shqyrtimit të çështjes

Shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën Kushtetuese duhet të fillojë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e kërkesës.

Neni 48
Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

1. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të.

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese.

KREU VII
PROCEDURAT E VEÇANTA

Procedura për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjeve
ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën dhe
me marrëveshjet ndërkombëtare

Neni 49

1. Për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të jo më pak se një të pestës të deputetëve dhe të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Këtë të drejtë e kanë edhe Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare, partitë politike, si dhe organizatat e tjera, vetëm kur argumentojnë se çështja lidhet me interesat e tyre.

Neni 50

Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre.

Neni 51

Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson:

përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative;

formën e ligjeve dhe të akteve normative;

c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.

Procedurat mbi pajtueshmërinë e marrëveshjeve
ndërkombëtare me Kushtetutën

Neni 52

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit.

2. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje për shqyrtimin e këtyre çështjeve vetëm pasi bëhet kërkesë nga subjektet e parashikuara në nenin 134 shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të Kushtetutës, si dhe nga subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f” të Kushtetutës, për çështje që lidhen me

interesat e tyre.

3. Në rast se çështja ka kaluar në seancë plenare, pezullohen procedurat për ratifikimin e marrëveshjes. Shqyrtimi i kërkesës përfundon brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së saj.

4. Në rast se Gjykata Kushtetuese vendos papajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën, ajo nuk mund të ratifikohet.

Neni 53

1. Marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe që janë të papajtueshme me të, mund të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese vetëm nga Këshilli i Ministrave.

2. Në rast se Gjykata Kushtetuese konstaton se marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj përmban dispozita që bien në kundërshtim me Kushtetutën, ajo vendos shfuqizimin e aktit të ratifikimit të saj.

Procedurat lidhur me mosmarrëveshjet e kompetencave

Neni 54

1. Në mbështetje të nenit 131 shkronja "ç" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton konfliktet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore dhe kur mosmarrëveshja ka lidhje të drejtëpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

2. Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe sipas rastit kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta.

3. Kërkesa para Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cënuara drejtpërdrejt nga konflikti.

4. Çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

Neni 55

Kërkesa për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve paraqitet brenda 6 muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

Neni 56

1. Gjykata Kushtetuese vendos se cili organ i pushtetit ka në kompetencë të tij zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja .

2. Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

Procedura për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive
dhe të organizatave të tjera politike

Neni 57

1. Për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit dhe të jo më pak se një të pestës së deputetëve.

2. Kërkesa mund të paraqitet në çdo kohë në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 58

Gjykata Kushtetuese shqyrton dhe vendos:
a) nëse partia ose organizata politike është krijuar në përputhje me dispozitat kushtetuese;
b) nëse veprimtaria e partisë ose e organizatës politike përputhet me Kushtetutën.

Neni 59

Kur Gjykata Kushtetuese çmon se ka të dhëna që veprimtaria e mëtejshme e një partie ose organizate politike cenon rendin kushtetues ose interesat shtetërorë apo publikë, sipas rastit, me vendim të veçantë të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare, mund të vendosë pezullimin e veprimtarisë së partisë ose të organizatës politike deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Neni 60

1. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se krijimi i një partie ose organizate politike vjen në kundërshtim me Kushtetutën, ajo shfuqizon aktin e krijimit.
2. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se veprimtaria e një partie ose organizate politike vjen në kundërshtim me Kushtetutën, ajo vendos sipas rastit ndalimin e kësaj veprimtarie ose urdhëron çregjistrimin e saj.

Procedurat për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës
dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij

Neni 61

1. Gjykata Kushtetuese për deklarimin e shkarkimit të Presidentit të Republikës vihet në lëvizje me vendimin e Kuvendit që ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra.
2. Vendimi i Kuvendit duhet të përmbajë një përshkrim të argumentuar të shkeljes së rëndë të Kushtetutës ose të krimit të rëndë, si dhe të shoqërohet me provat përkatëse.
3. Gjykata Kushtetuese, një kopje të vendimit të Kuvendit dhe të provave përkatëse, ia dërgon Presidentit të Republikës, i cili ka të drejtë të japë me shkrim sqarimet që i çmon të nevojshme.

Neni 62

1. Gjykata Kushtetuese për kalimin e çështjes në seancë plenare vendos me shumicën e anëtarëve të saj.
2. Në seancën plenare ka të drejtë të jetë i pranishëm Presidenti i Republikës ose një përfaqësues i tij.

Neni 63

1. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, deklaron shkarkimin e tij nga detyra. Në të kundërt, Gjykata Kushtetuese shfuqizon vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
2. Rregullat e përcaktuar në nenin 61 pikat 1, 2 dhe 3 zbatohen edhe në rastin e vërtetimit përfundimisht të faktit të pamundësisë së ushtrimit të detyrës nga Presidenti i Republikës. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos vërtetimin e faktit të pamundësisë për ushtrimin e detyrës ose rrëzon kërkesën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kur ajo nuk gjendet e bazuar.

Zgjedhshmëria dhe papajtueshmëria me ushtrimin
e funksioneve të Presidentit të Republikës

Neni 64

1. Për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e Presidentit të Republikës dhe për

papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të tij, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve ose të partive politike.

2. Në rastin e zgjedhshmërisë, Gjykata Kushtetuese vendos shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ose rrëzimin e kërkesës.

3. Në rastin e papajtueshmërisë për ushtrimin e detyrës, Gjykata Kushtetuese vendos deklarimin e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës ose rrëzimin e kërkesës.

Neni 65

Kur Presidenti i Republikës jep dorëheqjen gjatë kohës që çështja për shkarkimin e tij është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese ose mandati i tij përfundon, Gjykata Kushtetuese pushon procedimin e mëtejshëm. Gjykata Kushtetuese i rifillon procedurat kur kjo kërkohet nga Kuvendi ose nga ai vetë.

Procedura për shqyrtimin e zgjedhshmërisë
dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit

Neni 66

1. Për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës ose të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykata Kushtetuese verifikon zgjedhjen e deputetëve me kërkesë të partisë politike ose të kandidatit për deputet të pavarur, duke zbatuar në këtë rast edhe dispozitat ligjore për zgjedhjet e përgjithshme.

3. Kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi, përsa kohë vazhdon mandati i deputetit, ndërsa kërkesa për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve mund të paraqitet brenda 6 muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë.

Neni 67

1. Në rastet kur Gjykata Kushtetuese verifikon zgjedhshmërinë e deputetëve, ajo vendos, sipas rastit, rrëzimin e kërkesës ose shfuqizimin e aktit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për zgjedhshmërinë ose papajtueshmërinë e deputetit, Gjykata Kushtetuese, vendimin e saj ia dërgon Kuvendit.

Procedurat e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjeve
të kërkuara nga gjykatat

Neni 68

1. Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

2. Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojnë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cënuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij.

Neni 69

1. Gjykata Kushtetuese, kur konstaton se çështja nuk është e plotë dhe në përputhje me nenin 68 të këtij ligji, ia kthen atë gjykatës që e ka dërguar. Kjo e fundit detyrohet të plotësojë materialet brenda 1 muaji nga data e mbërritjes.

2. Kur materialet e dosjes janë të plota dhe në përputhje me nenin 68, Gjykata Kushtetuese

cakton datën e seancës për shqyrtimin e çështjes, duke njoftuar gjykatën dhe thirrur subjektet e interesuara.

Neni 70

1. Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjeve të parashikuara në nenet 68 e 69 të këtij ligji dhe për arsye që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e një ligji konkret, publikon faktin se çështja është nën shqyrtimin e saj.

2. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes materialet, së bashku me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, i dërgohen gjykatës konkrete.

3. Në rastet kur Gjykata Kushtetuese e shfuqizon ligjin si antikushtetues, vendimin e saj ia njofton Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.

Interpretimi i Kushtetutës

Neni 71

1. Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 124 të Kushtetutës bën interpretimin përfundimtar të saj.

2. Kërkesën për interpretim të Kushtetutës kanë të drejtë ta paraqesin subjektet e përmendura në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të paragrafit 1 të nenit 134 të Kushtetutës, ndërsa subjektet e tjera që përmenden në shkronjat "dh", "e", "ë" dhe "f", vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

3. Në kërkesën e paraqitur duhet të saktësohet se cila dispozitë apo pjesë e saj kërkohet të interpretohet.

4. Subjekti, që pretendohet se e ka interpretuar gabim Kushtetutën, është gjithashtu palë në gjykim.

5. Shqyrtimi i kërkesave të tilla mund të bëhet në seancë plenare edhe mbi shqyrtimin e dokumenteve.

KREU VIII
VENDIMET E GJYKATES KUSHTETUESE

Neni 72
Marrja e vendimit dhe shpallja e tij

1. Bisedimet si dhe votimi i vendimit bëhen pa praninë e personave të tjerë.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet.

3. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes.

4. Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij.

5. Vendimi jepet "Në Emër të Republikës së Shqipërisë".

6. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shpallet i arsyetuar dhe lexohet nga kryesuesi i seancës ose nga një gjyqtar i caktuar prej tij.

7. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar.

8. Gjyqtari që mbetet në pakicë ka të drejtë të arsyetojë mendimin e tij që i bashkohet vendimit dhe botohet bashkë me të.

9. Kopje të vendimit mund t'u jepen pjesëmarrësve në proces me kërkesën e tyre, kundrejt tarifës së caktuar.

Neni 73
Shtyrja e bisedimit dhe votimit

1. Kur ndonjëri prej gjyqtarëve që ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes mungon në bisedime ose në votim, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër.

2. Në qoftë se edhe pas kësaj, pjesëmarrja e gjyqtarit nuk mund të sigurohet brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vendos përfundimisht për çështjen, kur formohet shumica absolute e anëtarëve të saj.

3. Në rast se kjo shumicë nuk formohet dhe ekziston mundësia për përfshirjen në këtë gjykim të gjyqtarëve të tjerë, që më parë nuk kanë marrë pjesë në të, seanca riçelet dhe shqyrtimi i çështjes fillon nga e para.

Neni 74
Refuzimi i kërkesës

Kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendos refuzimin e kërkesës. Refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesi të riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

Neni 75
Mosndryshimi i vendimit

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pas votimit, konsiderohet i marrë dhe nuk mund të ndryshohet.

Neni 76
Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi.

2. Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm:

a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë;

ç) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.

Neni 77
Efektet juridike të vendimeve gjyqësore

Vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga çasti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i të cilës është shfuqizuar.

Neni 78
Njoftimi i vendimit

Kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj.

Neni 79
Vendimi interpretues

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që bën interpretimin e Kushtetutës ka fuqi prapavepruese.

Neni 80
Interpretimi dhe plotësimi i vendimit

1. Gjykata Kushtetuese nuk mund të anullojë ose të ndryshojë vendimin e saj, por ajo ka të drejtë:

a) të interpretojë vendimin në rast dyshimi ose mosmarrëveshje për kuptimin e tij, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen;

b) të plotësojë vendimin ose të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.

2. Shqyrtimi i çështjeve të mësipërme bëhet në seancë plenare, me pjesëmarrje të palëve.

Neni 81
Ekzekutimi i vendimeve

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim.

2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.

3. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, edhe mënyrën e ekzekutimit të tij.

4. Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 82
Mbarimi i mandatit dhe përtëritja

1. Mandati i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të zgjedhur në vitin 1992, mbaron në vitin 2001.

2. Gjyqtarët e tjerë zëvëndësues, të zgjedhur sipas ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, do të qëndrojnë në detyrë 12 vjet nga data e zgjedhjes.

3. Përtëritja e Gjykatës Kushtetuese pas vitit 2001 do të bëhet sipas mbarimit të mandatit të secilit gjyqtar.

Neni 83
Përjashtimi nga taksat dhe rregullimi i shërbimeve e shpenzimeve

1. Procedurat në Gjykatën Kushtetuese përjashtohen nga taksat.

2. Për shërbimet që kryhen, si dhe për shpenzimet e bëra gjatë gjykimit të çështjes, vendos Gjykata Kushtetuese.

Neni 84
Detyrimi për të dhënë dokumente

Çdo organ shtetëror, person fizik ose juridik, detyrohet t'i japë Gjykatës Kushtetuese dokumente, të dhëna e njoftime kur këto kërkohen e çmohen të nevojshme për shqyrtimin e çështjes.

Neni 85
Detyrimi për publikim i njoftimeve

Mjetet shtetërore të informimit janë të detyruara që të bëjnë publike njoftimet e dërguara nga

Gjykata Kushtetuese për çështje që lidhen me veprimtarinë e saj.

Neni 86
Zbatimi i ligjit të ri

Për kërkesat dhe çështjet që janë në shqyrtim datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 87
Shfuqizimi i ligjit

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji nr.8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Neni 88

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2561, datë 22.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
NR.8578, DATË 10.2.2000

PËR TEATRIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të sistemit teatror kombëtar.

Neni 2
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "Teatër" kuptohet ajo çka ndodh në shfaqje të gjallë e të drejtpërdrejtë ndërmjet artistit teatror dhe spektatorit.

b) "Vepër teatrore" kuptohet krijimi i gjallë artistik i një teksti, platforme, partiture a libreti, të përfunduar dhe të mundshëm për t'u shfaqur për së gjalli dhe drejtpërdrejt në publik.

c) "Veprimtari teatrore" kuptohet krijimi, prodhimi, ekzekutimi, tregtimi dhe shfrytëzimi i

veprës teatrore, zhvillimi i vlerave kombëtare teatrore, edukimi teatror dhe shërbimet e lidhura me këtë veprimtari.

ç) "Artistë teatrorë" kuptohen të gjithë ata, vepra e të cilëve është e paracaktuar të komunikojë për së gjalli dhe drejtpërdrejt me një auditor të caktuar.

E gëzojnë këtë cilësi si artistët dhe bashkëpunëtorët e veprës teatrore, edhe artistët që shfaqen në publik.

d) "Fondi publik i teatrit" kuptohet fondi i miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, si dhe të ardhurat e tjera, të njohura me ligj, të paracaktuara për financimin e veprimtarisë teatrore kombëtare.

dh) "Qendra Kombëtare e Teatrit" është institucioni shtetëror kombëtar, i cili nëpërmjet administrimit të fondit publik të teatrit, bën bashkërendimin, organizimin dhe financimin e veprimtarisë teatrore në Shqipëri.

e) "Kompani teatrore" kuptohet personi fizik ose juridik, privat ose shtetëror, vendas ose i huaj, i cili merr përgjegjësinë e realizimit të veprimtarisë teatrore dhe gëzon cilësinë e pronarit të saj.

ë) "Qendër teatrore ose qendër arti" kuptohen institucionet publike dhe private, të përcaktuara që më parë si të tilla, të paracaktuara të shërbejnë për edukim, prodhim dhe shfaqje të veprës teatrore dhe të veprimtarive të tjera artistike.

f) "Projekt teatror" kuptohet çdo ide, e zhvilluar dhe e plotësuar deri në nivelin e shpjegimit të kuptueshëm, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e saj në cilësinë e veprës teatrore. Projekti teatror mund të jetë i sferës së prodhimit, të edukimit, të promovimit, tradicional ose alternativ, privat ose shtetëror.

g) "Aplikim" kuptohet kërkesa e kompanisë teatrore për financimin nga fondi publik i teatrit, mbështetur në rregulloret dhe në tarifat e përcaktuara nga Qendra Kombëtare e Teatrit, për realizimin e një ose më shumë projekteve teatrore.

gj) "Mbështetje financiare" kuptohet masa e financimit të një projekti teatror dhënë kompanisë teatrore nga fondi publik i teatrit.

KREU II
INSTITUCIONET PUBLIKE TË TEATRIT DHE ORGANIZIMI I TYRE
QENDRA KOMBËTARE E TEATRIT DHE STRUKTURAT E SAJ

Neni 3
Qendra Kombëtare e Teatrit

Qendra Kombëtare e Teatrit ka selinë, stemën, vulën dhe llogarinë bankare.

Neni 4
Varësia dhe organizimi i Qendrës Kombëtare të Teatrit

Qendra Kombëtare e Teatrit është institucion në varësi të Këshillit të Ministrave. Organizimi, struktura dhe funksionimi përcaktohen në statusin e saj, i cili miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 5
Detyrat e Qendrës Kombëtare të Teatrit

Qendra Kombëtare e Teatrit ka këto detyra:

a) Zbaton politikat shtetërore në fushën e artit teatror, të miratuara në programin e Këshillit të Ministrave.

b) Zbaton ligjet, aktet nënligjore dhe administrative për funksionimin e veprimtarisë teatrore në Shqipëri.

c) Shpall publikisht, në krye të vitit, fondin publik të teatrit, jo më vonë se 1 muaj pas detajimit të Buxhetit të Shtetit.

ç) Bën ndarjen e fondit publik të teatrit për njësitë e veçanta të veprimtarisë teatrore dhe në

bazë të shtrirjes gjeografike të kësaj veprimtarie.

d) Harton rregulloret për mënyrën e paraqitjes së formularëve të aplikimit, të kushteve të kontraktimit, të tarifave të shërbimeve dhe të kuotave të shpërblimit, në bazë të të cilave jepet financimi për projektet e aplikuara dhe të shpallura fituese.

dh) Paraqet çdo vit kërkesat për mbështetje buxhetore në fondin publik të teatrit dhe mbikëqyr përdorimin e financimeve nga kompanitë teatrore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

e) Ndjek dhe realizon bashkëpunimin ndërshtetëror në fushën e veprimtarisë teatrore, mbështetur në konventat ndërkombëtare dhe në marrëveshjet dypalëshe, të nënshkruara nga shteti shqiptar me shtetet e tjera.

ë) Mbledh, përpunon dhe u shpërndan kompanive teatrore dhe subjekteve të tjera të saj informacion të vlefshëm në fushat e prodhimit, të edukimit dhe të promovimit të veprimtarisë teatrore.

f) Nxit dhe financon projekte në fushën e botimit të literaturës dhe të informacionit teatror.

g) Nxit, bashkëpunon, financon dhe bashkëfinancon projekte e programe në fushën e edukimit, të prodhimit dhe të shpërndarjes së veprimtarive teatrore kombëtare dhe ndërkombëtare.

gj) Mbështet dhe financon, plotësisht ose pjesërisht, projekte promovimi, si festivale të teatrit turne, pjesëmarrje ndërkombëtare.

h) Siguron asistencë teknike në shërbim të rritjes cilësore dhe të standardizimit të aplikimit të projekteve teatrore.

i) Përgatit dhe organizon mbledhjen e Këshillit Artistik Kombëtar të Teatrit (KAKT).

j) Regjistron dhe licencon kompanitë teatrore.

Neni 6

Mënyra e zgjedhjes dhe emërimi i Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Teatrit

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kryetari përzgjidhet ndërmjet 2 fituesve të konkursit publik, të shpallur dhe të organizuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas kritereve të përcaktuara prej këtij të fundit.

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit emërohet për 4 vjet me të drejtë riemërimi. Ai mund të shkarkohet nga Kryeministri përpara mbarimit të mandatit, vetëm në rast se vërtetohet se ka kryer shkelje kushtetuese dhe ligjore.

Neni 7

Detyrat e Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Teatrit

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit ka këto detyra:

a) I paraqet Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve strukturën administrative të Qendrës Kombëtare të Teatrit.

b) Miraton rregulloren e funksionimit të Këshillit Artistik Kombëtar të Teatrit.

c) Miraton projektet teatrore, të klasifikuara nga Këshilli Artistik Kombëtar i Teatrit. Ai ka të drejtë t'i kthejë këto projekte vetëm 1 herë për rishikim në Këshillin Artistik Kombëtar të Teatrit, kur ka vërejtje dhe sugjerime në lidhje me to. Kjo procedurë dhe përfundimet e saj bëhen publike.

ç) Miraton projekte të kufizuara financiarisht, shuma e të cilave nuk kalon 5 për qind të vlerës së përgjithshme të fondit vjetor publik të teatrit, por jo më shumë se 2 projekte në vit.

d) Përfaqëson institucionin dhe gëzon cilësinë e autoritetit shtetëror të teatrit shqiptar.

dh) Nënshkruan kontratat e financimit me kompanitë teatrore për projektet e shpallura fituese.

Neni 8

Caktimi i komisioneve të përkohshme dhe i këshilltarëve

Për projekte dhe nevoja të veçanta, Kryetari i Qendrës Kombëtare të Teatrit ka të drejtë të krijojë komisione të përkohshme ose të marrë bashkëpunëtorë ose këshilltarë të jashtëm.

Shpërblimi i tyre bëhet me honoraret e parashikuara në shpenzimet e projektit, sipas tarifave të

përgjithshme, në bazë të të cilave aplikohet për financim.

FONDI PUBLIK I TEATRIT

Neni 9
Shpallja e fondit publik të teatrit

Fondi publik i teatrit shpallet publikisht me miratimin e Buxhetit vjetor të Shtetit.

Neni 10
Mosndryshimi i drejtimit të fondit publik të teatrit

Fondit publik të teatrit nuk mund t'i ndryshohet drejtimi. Ky fond krijohet, përdoret dhe menaxhohet në përputhje me parimet dhe me rregullat e përcaktuar në legjislacionin shqiptar dhe në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".

Neni 11
Burimet financiare të fondit publik të teatrit

Burimet financiare të fondit publik të teatrit janë:

I. Buxheti i shtetit.

II. Të ardhura të tjera jobuxhetore nga:

a) pagesat e regjistrimeve, të licencimeve dhe të shërbimeve të tjera administrative të Qendrës Kombëtare të Teatrit;

b) biletat dhe faturat e tjera të shitjes së veprave teatrore, llogaritur në bazë të përqindjes së financimit të përfituar nga fondi publik i teatrit;

c) shitjet e botimeve, të katalogëve, të udhëzimeve teatrore etj., të financuara nga fondi publik i teatrit;

ç) të ardhurat nga donatorë ose sponsorë të ndryshëm;

d) të ardhura të lejuara me ligj.

KËSHILLI ARTISTIK KOMBËTAR I TEATRIT

Neni 12
Këshilli Artistik Kombëtar i Teatrit

Këshilli Artistik Kombëtar i Teatrit (KAKT) është organizëm i pavarur, që vepron pranë Qendrës Kombëtare të Teatrit.

KAKT-i vepron si një forum i vetëm. Ai merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash, kur në të marrin pjesë jo më pak se 50 për qind plus një e të gjithë anëtarëve.

Neni 13
Zgjedhja e anëtarëve të KAKT-it

KAKT-i përbëhet nga 11 anëtarë, përfaqësues të shquar të artit kombëtar, me tituj artistikë. Anëtarët e KAKT-it janë përfaqësues të këtyre institucioneve:

Teatri Kombëtar i Dramës: 2 përfaqësues.

b) Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit: 2 përfaqësues.

c) Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore: 2 përfaqësues.

ç) Teatri Kombëtar për Fëmijë: 1 përfaqësues.

d) Teatrot vendore: 2 përfaqësues.

dh) Teatrot private: 1 përfaqësues.
e) Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve: 1 përfaqësues.

Neni 14
Kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të KAKT-it

Anëtarët e KAKT-it zgjidhen për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Ata zgjidhen me votim të fshehtë nga këshillat artistikë të institucioneve teatrore. Ata nuk mund të jenë njëkohësisht drejtues të këtyre institucioneve, kryetarë të këshillave artistikë të tyre ose aksionerë të këtyre institucioneve.

KAKT-i zgjedh me votim të fshehtë Kryetarin dhe zëvendëskryetarin e tij.

Kur një anëtar i KAKT-it largohet për arsye të ndryshme, ai zëvendësohet nga institucioni, të cilit i përkiste anëtari i larguar.

Neni 15
Mbledhjet e KAKT-it dhe shpërblimi

KAKT-i mblidhet të paktën dy herë në vit, në përputhje me rregulloren e funksionimit të tij. Me kërkesë të Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Teatrit mblidhet edhe jashtë radhe.

Masa e shpërblimit të anëtarëve të KAKT-i përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16
Detyrat dhe mënyra e punës së KAKT-it

KAKT-i përzgjedh dhe klasifikon projektet teatrore nga pikëpamja cilësore, kulturore dhe ekonomike.

KAKT-i merr vendim vetëm pasi është njohur me projektin e aplikuar dhe me relacionet e strukturave përkatëse të Qendrës Kombëtare të Teatrit, si dhe pasi ka dëgjuar shpjegimet e aplikuesit.

Vendimi i KAKT-it përfshin miratimin e projektit artistik dhe fondin përkatës financiar.

KREU III
KOMPANIA TEATRORE
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 17
Kuptimi i kompanisë teatrore

Kompani teatrore është çdo person fizik ose juridik, privat ose shtetëror, vendas ose i huaj, që merr nismën dhe përgjegjësinë kulturore, ekonomike, juridike e morale të kryejë veprimtari në fushën e prodhimit, të edukimit dhe të promovimit të artit teatror.

Kompanitë teatrore organizohen dhe funksionojnë sipas statusit të tyre dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 18
Llojet e kompanive teatrore

Kompanitë teatrore mund të jenë qendrore ose vendore, shtetërore ose private, të përkohshme, të rastësishme, të përhershme, individuale ose kolektive.

Neni 19
Statusi i kompanive teatrore shtetërore dhe i punonjësve të tyre

Kompanitë teatrore shtetërore kombëtare janë institucione buxhetore ose shoqëri tregtare shtetërore. Statusi i tyre do të jetë në varësi të formës juridike të funksionimit të tyre.

Neni 20

Marrëdhëniet e kompanive teatrore me Qendrën Kombëtare të Teatrit

Të gjitha kompanitë teatrore janë të barabarta përpara Qendrës Kombëtare të Teatrit dhe të pavarura prej saj.

Klasifikimi dhe përfitimi i financimit mbështeten mbi parimet e barazisë në konkurrim, në vlerat kulturore e kombëtare, si dhe mbi efektivitetin ekonomik të projektit.

Neni 21

Kushtet për gëzimin e së drejtës së aplikimit

Kompania teatrore gëzon të drejtën e aplikimit për financim nga fondi publik i teatrit vetëm pasi është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Teatrit dhe ka deklaruar pranimin e rregullave, të tarifave dhe të kuotave të shpërblimit të shpallura prej saj.

Neni 22

Llojet e financimeve nga Qendra Kombëtare e Teatrit

Kompania teatrore ka të drejtë të kërkojë nga Qendra Kombëtare e Teatrit financim të pjesshëm ose të plotë për një projekt të vetëm teatror, për një projekt stinor teatror, deri për një projekt vjetor.

Kompanitë teatrore shtetërore qendrore kanë të drejtë ekskluzive të paraqitjes së projektit vjetor teatror dhe të përfitimit nga fondi publik i teatrit të subvencionit të plotë për projektin e miratuar nga KAKT-i.

Neni 23

Kushtet e funksionimit

Kompania teatrore është e lirë të kontraktojë shërbimet e projektit në kushtet e tregut. Ajo është e lirë të kontraktojë artistë dhe bashkëpunëtorë, në bazë të ofertë-kërkesës.

Për financimin e përfituar nga fondi publik i teatrit, ajo është e detyruar të pranojë kuotat dhe tarifat e Qendrës Kombëtare të Teatrit.

Neni 24

Shlyerja e detyrimeve të financimit

Pasi ka shlyer detyrimet që burojnë nga financimi, parashikuar në kontratën e saj me Qendrën Kombëtare të Teatrit, kompania teatrore gëzon të drejtën e pronësisë ekonomike dhe të përdorimit të lirë të veprës teatrore.

Neni 25

Kuota e shpenzimeve administrative

Shpenzimet administrative të një projekti teatror të financuar nuk duhet të kalojnë 10 për qind të të gjithë vlerës së financimit.

Neni 26

Mosndryshimi i drejtimit të fitimit të siguruar nga veprimtaria teatrore e financuar

Të gjitha të ardhurat e siguruara nga shitja e veprës teatrore, të realizuara me pjesëmarrjen e financimit të fondit publik të teatrit, kompania teatrore është e detyruar t'i përdorë në projektin e ardhshëm teatror. Në rast shkeljeje të këtij detyrimi, kompania teatrore humbet të drejtën për të

përfituar financim të ri nga ky fond.

KOMPANITË TEATRORE SHTETËRORE QENDRORE

Neni 27
Qëllimi i kompanisë teatrore shtetërore qendrore

Qëllimi i kompanisë teatrore shtetërore qendrore është nxitja, stimulimi dhe përparimi i artit teatror, si krijimtari shpirtërore e popullit dhe ruajtja e identitetit kombëtar kulturor, nëpërmjet studimit, edukimit dhe paraqitjes së veprës teatrore, klasike dhe bashkëkohore, eksperimentimit të formave të reja teatrore, realizimit të veprave për të gjitha grupet e shtresat sociale, shkëmbimeve teatrore ndërkombëtare, turneve, manifestimeve intelektuale, riprodhimit audioviziv të veprës teatrore, botimeve etj.

Neni 28
Varësia e kompanive teatrore shtetërore qendrore

Kompanitë teatrore shtetërore qendrore, të krijuara ose të shndërruara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji, janë institucione publike në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 29
Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore qendrore

Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore qendrore janë:

Buxheti i Shtetit për shpenzimet e administratës.

b) Të ardhurat e siguruara nga projektet e saj, të shpallura fituese nga Qendra Kombëtare e Teatrit.

c) Të ardhurat nga shitjet e veprës së saj teatrore.

ç)Të ardhurat nga shërbimet që kompania u bën të tretëve.

d) Sponsorizimet e donacionet.

Neni 30
E drejta e selisë

Kompanitë teatrore shtetërore qendrore i kanë selitë e tyre në godinat e qendrave kombëtare të artit, në përputhje me përkatësinë e tyre artistike e funksionale.

Neni 31
Zgjedhja e drejtorit

Kompania teatrore shtetërore qendrore udhëhiqet nga drejtori, i cili emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Drejtori propozon statutin dhe strukturën organizative të administratës së tij, të cilat miratohen nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 32
Këshilli artistik i kompanive shtetërore teatrore

Veprimtaria e kompanive shtetërore teatrore qendrore dhe vendore organizohet në bazë të statutit të tyre. Ky statut propozohet nga këshilli artistik i kompanisë teatrore përkatëse dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Veprimtaria artistike e kompanive teatrore udhëhiqet nga këshillat artistike. Këto zgjidhen me

votim të fshehtë nga trupa artistike e institucionit përkatës. Procedurat e zgjedhjes, kompetencat e tyre, numri i anëtarëve dhe afati i zgjatjes së mandatit përcaktohen në statutin e tyre.

KOMPANITË TEATRORE SHTETËRORE VENDORE

Neni 33
Statusi i kompanive teatrore shtetërore vendore dhe varësia e tyre

Kompanitë teatrore shtetërore vendore janë institucione buxhetore ose shoqëri tregtare, që krijohen ose shndërrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji, me nismën, vullnetin e pushtetit vendor dhe janë në vartësi të këtij pushteti.

Statusi i kompanive teatrore shtetërore vendore propozohet nga këshillat artistikë dhe miratohet nga këshillat e bashkive përkatëse, sipas një statuti tip të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 34
Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore vendore

Burimet financiare të kompanisë teatrore shtetërore vendore sigurohen nga:
a) buxheti i shtetit për pushtetin vendor për shpenzimet administrative;
buxheti i pushtetit vendor për kulturën;
c) të ardhurat e siguruara nga projektet fituese në Qendrën Kombëtare të Teatrit;
ç) të ardhurat nga shitja e veprës teatrore;
d) të ardhura nga shërbimet, që kompania teatrore u bën të tretëve;
dh) sponsorizimet e donacionet.

Neni 35
E drejta e selisë

Kompanitë teatrore shtetërore, vendore e kanë selinë në qendrën vendore të artit.

Neni 36
Zgjedhja e drejtorit

Drejtori i kompanive shtetërore vendore emërohet nga strukturat përgjegjëse të pushtetit vendor. Procedurat e emërimit të tij përcaktohen në statutin tip.

Neni 37
Kontraktimi i artistëve teatrorë

Artistët teatrorë hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me kompaninë teatrore shtetërore vendore sipas nevojave, përmasave të veprimtarisë teatrore, suksesit të repertorit, brenda fondit financiar të përfituar.

KREU IV
QENDRA TEATRORE OSE QENDRA E ARTIT

Neni 38
Kuptimi i qendrave teatrore ose i qendrave të artit

Qendrat teatrore janë institucionet shtetërore ekzistuese ose ato që do të krijohen në të ardhmen, që kanë kapacitetet dhe infrastrukturën fizike dhe administrative të domosdoshme për shërbimet e prodhimit, të edukimit, të shpërndarjes, të promovimit dhe të shfaqjes së veprës teatrore dhe të veprave të tjera, artistike e kulturore.

Qendrat e artit mund të emërtohen edhe në cilësinë e një arti të vetëm ose mund të mbajnë emërtime të tjera, të zgjedhura në përputhje me funksionet e kësaj qendre.

Neni 39
Pronësia e qendrave ekzistuese të artit

Qendrat ekzistuese të artit janë pronë shtetërore. Qendrat qendrore janë në pronësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndërsa qendrat vendore janë në pronësi të pushtetit vendor.

Neni 40
Marrëdhëniet e qendrave të artit me të tretët

Qendra e artit hyn në marrëdhënie kontraktore, shërbimi e bashkëpunimi me kompanitë teatrore dhe me persona të tjerë, fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari artistike e kulturore për projekte të veçanta ose stinore.

Qendra e artit, në përputhje me ofertë-kërkesën dhe me lëvizjet e tregut, harton dhe publikon tarifat e shërbimeve të saj, të cilat miratohen nga organi epror.

Neni 41
Bashkëjetesa afatgjatë

Bashkëjetesa, nën një politikë dhe administrim të përbashkët dhe afatgjatë, ndërmjet qendrës së artit dhe kompanisë teatrore (ose të një personi tjetër juridik, privat apo shtetëror) bëhet me miratimin e pronarit të qendrës dhe mënyrat e bashkëjetesës pasqyrohen në një kontratë të posaçme, mbështetur në parimet e këtij ligji.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 42
Krijimi i kompanisë teatrore shtetërore qendrore të operas dhe baletit

Krijohet kompania teatrore shtetërore qendrore e operas dhe e baletit, me emërtimin "Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit", me seli në Qendrën Kombëtare të Arteve, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 43
Krijimi i Qendrës Kombëtare Teatrore të Operas dhe Baletit

Godina dhe infrastruktura e Teatrit të Operas dhe Baletit shndërrohet në Qendrën Kombëtare Teatrore të Operas dhe Baletit, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 44
Krijimi i kompanisë teatrore shtetërore të artit dramatik

Krijohet kompania teatrore shtetërore e artit dramatik, me emërtimin "Teatri Kombëtar", me seli në godinën e Qendrës Kombëtare Teatrore të artit dramatik, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 45
Krijimi i Qendrës Kombëtare Teatrore të Artit Dramatik

Godina dhe infrastruktura e Teatrit Kombëtar shndërrohet në Qendrën Kombëtare Teatrore të

Artit Dramatik, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 46
Inventarizimi i qendrave të artit

Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor, të bëjë inventarizimin e përgjithshëm të qendrave të artit.

Ndërtesa dhe infrastruktura e teatrove kombëtare qendrore e vendore nuk mund të tjetërsohen dhe as të jepen në përdorim për qëllime joartistike.

Neni 47
Krijimi i kompanisë teatrore shtetërore qendrore të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore

Krijohet kompania teatrore shtetërore qendrore e Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore me seli në Qendrën Teatrore Kombëtare të Teatrit të Operas dhe Baletit, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 48

Krijohet kompania teatrore shtetërore qendrore e Teatrit Kombëtar për Fëmijë me seli në Teatrin e Kukullave të Tiranës, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 49

Godina dhe infrastruktura e Teatrit të Kukullave shndërrohet në Qendrën Kombëtare Teatrore për Fëmijë, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 50
Mbrojtja ekonomike e artistëve teatrorë

Artistët teatrorë, që si rezultat i zbatimit të këtij ligji humbasin vendin e punës në institucionet e mbyllura ose të shndërruara, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ekonomike nga shteti, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 51

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji jo më vonë se 90 ditë nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2562, datë 22.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Doli nga shtypi më 13.1.2000

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja ALBDESIGN sh.p.k.
Tiranë, 2000

Çmimi: 150 lekë